Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së

Falënderime

Ky botim është hulumtuar dhe përgatitur për Programin Antitrafikim të OSBE/ODIHR nga Katy Thompson dhe Allison Jernow.

Studiueset nuk do të mund ta kishin kryer këtë studim pa ndihmën e organizatave dhe njerëzve që vijojnë: Prezenca e OSBE-së Shqipëri, në veçanti Juliana Rexha (Këshilltare vendase për Anti-trafikimin); Zyra e OSBE-së në Ukrainë, në veçanti Begona Piniero dhe Hlib Jasnicki; Misioni i OSBE-së në Moldavi, në veçanti Antonia Demeo dhe Otilia Bologan-Vieru; ADPARE në Rumani, në veçanti Alexandra Surcel; Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në Shqipëri, në veçanti Besa Saraçi dhe Aurela Bozo; Asociatia Femeia Pentru Societate, Moldavi, në veçanti Veronica Lupu; Poppy Project, Mbretëria e Bashkuar, në veçanti Sarah Stephens-Smith; Grupi i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut (Mbretëri e Bashkuar), në veçanti Bronwyn Byrnes; Elena Tyuryukanova (Federata Ruse); Georgina Vaz Cabral (Francë); Benedict Bourjois (Francë); Robert Moossy, Drejtor dhe Lorna Grenadier, Koordinatore për Viktimat/Dëshmitarët e Njësisë së Hetimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Drejtoria e të Drejtave Qytetare, Departament i Drejtësisë, SHBA dhe avokatët me përvojë të çështjeve civile Dan Werner, Kathleen Kim dhe Kent Felty (SHBA).

Ky material u përkthye nga anglishtja në shqip nga Adelina Albrahimi dhe u redaktua nga Kathleen Imholz. Përkthimi nuk do të ishte përfunduar pa ndihmën e Frank Dalton, Violeta Librazhdi, Juliana Rexha, Edlira Ngjeçi dhe Erion Fejzulla të cilët redaktuan materialin në shqip.

Falënderojmë gjithashtu për dialogun e frytshëm, materialet dhe ndihmën: Beate Andrees, Gao Yun dhe Alexander Iafaev, ILO; Richard Danzinger, IOM; Jyothi Kanics i Këshillit Irlandez për Refugjatët; Michele Levoy, PICUM, Jans Matthes, UNICEF; Andrew Painter, UNHCR; Gabriele Reiter; Liliana Sorrentino dhe Anelise Gomes de Araujo, Zyra e Përfaqësueses së Posaçme dhe Koordinatores për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, OSBE; Don Flynn, PICUM; Mike Dottridge; Rhodri Williams; dhe Marieke van Doorninck, La Strada International.

Ky raport u paraqit si dokument diskutimi në seminarin e ODIHR-it mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar, i cili u zhvillua në Barcelonë më 10-12 dhjetor 2007. Falënderojmë gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit në seminar për kontributin aktiv në pasurimin e mëtejshëm të këtij raporti: Omer Ahmed, Sindikata e Transportit dhe e Punëtorëve të Përgjithshëm (Mbretëri e Bashkuar); Nataliya Akhtyrska, Akademia e

Gjyqtarëve (Ukrainë); Profesore Aurela Anastasi, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (Shqipëri); Alovsat Aliyev, Qendra e Ndihmës Ligjore për Emigrantët (Azerbajxhan); Funda Bacinoglu, Shërbimi Ligjor i Avokatëve Ankara (Turqi), Julie Barton, Poppy Project (Mbretëria e Bashkuar); Dr. Machteld Boot-Mattijssen, Zyra e Raportuesit Hollandez për Trafikimin (Hollandë), Benedicte Bourgeois, Comité contre l'esclavage moderne (Francë); Reyes Castillo, PICUM dhe ACCEM (Spanjë); Tatiana Catana, Shoqata e Grave Juriste në Karrierë (Moldavi); Anton Chazov, IOM (Federata Ruse); Iulia Diaconu, Prokurore (Rumani); Marieke Van Doorninck, La Strada International (Hollandë); Yun Gao, ILO (Gjenevë); Marta Gonzalez, Proyecto Esperanza (Spanjë); Lorna Grenadier, Koordinatore e Viktimave Dëshmitare (SHBA); Robin Harms, Zyra e Përfaqësueses së Posaçme të OSBE-së dhe Koordinatores për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Vienë); Natalia Ieseanu, Tampep (Itali); Mary Japaridze, Neni 42 i Kushtetutës (Gjeorgji); Ulas Karan, Universiteti Bilgi i Stambollit (Turqi); Carl Kelvin, Shërbimi Mbretëror i Prokurorisë (Mbretëri e Bashkuar); Ketevan Khucishvili, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm (Gjeorgji); Janice Lam, Anti-Slavery International (Mbretëri e Bashkuar); Veronica Lupu, Shoqata e Grave Juriste në Karrierë (Moldavi); Dominique Mallassagne, Zyra për Ndihmën ndaj Viktimave, Drejtoria e së Drejtës dhe Drejtësisë (Francë); Vladimir Misev, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë); Marina Meskhi, Fondi Shtetëror për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave të Trafikimit (Gjeorgji); Veronica Pavel, Juriste (Rumani); Yuri Poliakov, Jurist (Federata Ruse); Juliana Rexha, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tetyana Rudenko, Zyra e Koordinatorit të Projektit të OSBE-së në Ukrainë, Elena Volochai, Juriste (Ukrainë) dhe Daniel Werner, Qendra Ligjore në Mbrojtje të të Drejtave të Punëtorëve në New York (SHBA).

Shënim:

Kërkimet fillestare për këtë studim përfunduan në prill 2007. Botimi fillestar i këtij libri në anglisht u bë në maj 2008. Për botimin në shqip, të botuar në dhjetor 2010, nuk janë bërë përditësimet përkatëse, por janë korrigjuar gabimet e mundshme. Kjo nuk ka ndikuar në përfundimet dhe rekomandimet.

Shkurtime dhe akronime

KPP	Kodi i Procedurës Penale
KEDVKDh	Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme
BE	Bashkimi Evropian
ONQ	Organizatë ndërqeveritare
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migracionit
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
OJF	Organizatë joqeveritare
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
KPU OSBE	Koordinatori i Projektit të OSBE-së në Ukrainë
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
KKBKON	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

Shkurtime të monedhave kombëtare (sipas listës ISO 4217, lista e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin)

ALL	Leku i Shqipërisë
EUR	Euro i Bashkimit Evropian
GBP	Paund i Mbretërisë së Bashkuar
MDL	Leu i Moldavisë
ROL	Leu i vjetër i Rumanisë
RON	Leu i ri i Rumanisë
RUB	Rubla e Rusisë
UAH	Hrivnia e Ukrainës
USD	Dollari i SHBA-së

numër të lartë rastesh në SHBA, Ukrainë dhe Moldavi ku personave të trafikuar u është dhënë dëmshpërblimi nëpërmjet padisë civile brenda procesit penal. Në Mbretërinë e Bashkuar, gjykata urdhëron dëmshpërblimin brenda procesit penal, si pjesë e masës së dënimit. Në praktikë, kjo është kufizuar në një shumë të vogël simbolike.

Masa e dëmshpërblimit të dhënë nga gjykatat ndryshon midis vendeve dhe brenda vendeve. Megjithatë, në të gjitha vendet ekziston një problem madhor i moskryerjes së pagesës së dëmshpërblimit, duke i lënë personit të trafikuar barrën e ndjekjes së procedurave të ekzekutimit kundrejt trafikantit/shfrytëzuesit. Gjithashtu, zbatimi i vendimeve shpesh nuk është i suksesshëm, që do të thotë se, pavarësisht ekzistencës së disa mekanizmave të dëmshpërblimit, është jashtëzakonisht e rrallë marrja e shumës së dëmshpërblimit nga personi i trafikuar.

Personat e trafikuar gjithashtu mund të kërkojnë dëmshpërblim nga trafikanti/shfrytëzuesi nëpërmjet legjislacionit të punës në rastet kur legjislacioni vendas njeh të drejtat e punës së këtyre personave. Kjo mund të varet nga statusi i emigracionit që ka individi, nga baza dhe natyra e kontratës së punës dhe nga fakti nëse puna është "e ligjshme." Ka edhe organe kombëtare që rregullojnë standardet e punësimit, për shembull inspektorët e punës që kanë të drejtë të ngrenë padi ndaj punëdhënësve ose t'ua referojnë rastet autoriteteve gjyqësore, të cilat çojnë në pagesën e dëmshpërblimit, për shembull për mosdhënien e pagës ose për dëmtimet në punë. Këto lloj veprimesh të palëve të treta kundrejt një punëdhënësi shfrytëzues ndihmojnë personat e trafikuar, duke shmangur nga ana e tyre nevojën për të ndjekur një rast individualisht.

Më së shumti, të gjitha paditë ndaj trafikantit/shfrytëzuesit kërkojnë pjesëmarrjen aktive të personit të trafikuar në procesin gjyqësor, duke dhënë dëshmi gojore dhe me dokumente ne lidhje me shkeljen e kryer, dëmin dhe humbjen e pësuar. Sipas këtij raporti, kjo mund të sjellë ndrojtjen e viktimës, dhe ndihma ligjore falas dhe përfaqësimi janë të domosdoshme për të rritur mundësitë e individit të kryejë procedurat dhe të marrë shpërblimin. Gjithashtu, kjo kërkon kohë dhe mund të jetë e kushtueshme. Të provosh dëmin nëpërmjet provave të viktimizimit të kaluar dhe të tanishëm, si dhe emërtimet apo përkufizimet e disa kategorive të dëmit si "humbja e dinjitetit," mund të kenë efekt ritraumatizues mbi personin e trafikuar.

Për shkak të këtyre problemeve dhe mospagesës së dëmshpërblimit, sugjerohet në këtë vlerësim se dëmshpërblimi nëpërmjet marrëveshjeve vullnetare apo të ndërmjetësuara, ose të kërkuara nga një palë e tretë (p.sh sindikata nëpërmjet një procedimi kolektiv apo inspektoriati i punës), mund të kenë një shans më të madh suksesi për t'u paguar si dhe

procedimi të jetë më pak traumatizues për personin e trafikuar. Kështu, duhen shfrytëzuar metodat e kryerjes së veprimeve kolektive dhe ndërmjetësimeve nga aktorët shtetërorë ose të shoqërisë civile (p.sh., OJF-të ose sindikatat).

Përveç mundësisë për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti/shfrytëzuesi, në Francë, Mbretëri e Bashkuar, Rumani dhe SHBA ekziston dhe mundësia për të kërkuar dëmshpërblim nga një fond shtetëror. Zakonisht nga ky fond përfitojnë viktimat e krimeve të dhunshme ose kur është shkaktuar dëmi. Këto sisteme zakonisht kompensojnë lloje të veçanta të dëmit material (financiare), ndonëse në Francë dhe Mbretëri të Bashkuar mund të kërkohet dëmshpërblim dhe për lloje të tjera dëmi (si 'dhimbje dhe vuajtje'). Këto mekanizma janë relativisht të thjeshtë për sa u përket procedurave dhe garantojnë pagesën. Megjithatë, mundësia e përfitimit nga këta mekanizma kufizohet nga kombësia dhe kërkesat në lidhje me karakterin e kërkuesit, të cilat janë përdorur për të shpallur të pavlefshme kërkesat e personave të trafikuar. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë, ka OJF me përvojë të gjatë dhe ekspertizë që ndihmojnë viktimat të paraqesin kërkesë për përfitime nga këto fonde.

Shërbimet e këshillimit për personat e trafikuar janë një element thelbësor i së drejtës për dëmshpërblim. Për të kërkuar dëmshpërblimin, personat e trafikuar duhet domosdoshmërisht të kenë dijeni për të drejtat e tyre dhe si mund t'i marrin ato. Duhet të ekzistojnë dhe masa që garantojnë sigurinë dhe mirëqenien e personit gjatë kohëzgjatjes së procedurës. Kjo do të thotë se strehimi i përshtatshëm, ndihma sociale, këshillimi ligjor, ndihma mjekësore dhe leja e qëndrimit janë të drejta ndihmëse thelbësore, pa të cilat mundësia për të përfituar dëmshpërblimin është e kufizuar. Në mënyrë më të mirë, duhet siguruar që personi ka mbështetjen e mjaftueshme dhe është në gjendje të paraqesë prova për të mbështetur pretendimet.

Ka dhe shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në suksesin e padive për dëmshpërblim: mungesa e provave të disponueshme për të mbështetur pretendimet, apo ligjet të cilat nuk lejojnë që pasuritë e sekuestruara të përdoren për dëmshpërblim, mund të ndikojnë dukshëm në rezultatin e padisë. Gjithashtu, mund të dalin vështirësi në ngritjen e padisë ligjore kur trafikanti ndiqet penalisht në një vend tjetër nga ai ku ndodhet viktima, ose kur pasuria e trafikantit ndodhet në një vend tjetër nga ai ku vendoset dëmshpërblimi. Së fundi, është i domosdoshëm funksionimi i shtetit të së drejtës; sistemi i dëmshpërblimit mund të funksionojë vetëm po aq mirë sa mjedisi gjyqësor dhe administrativ në secilin vend, prandaj është e rëndësishme që të ekzistojë një kulturë pavarësie, aftësie dhe eficience, veçanërisht në punën e gjyqësorit dhe të prokurorisë.

Sipas këtij raporti, grupet e shoqërisë civile kanë luajtur një rol thelbësor në zhvillimin dhe zbatimin e së drejtës të dëmshpërblimit. OJF-të dhe sindikatat kanë lobuar me qeveritë për ndryshime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ato kanë qenë dinamika e reformave në nivel kombëtar dhe kanë punuar për sigurimin e shërbimeve të domosdoshme për personat e trafikuar.

Situata e fëmijëve nuk trajtohet gjerësisht në këtë raport për shkak të vështirësive për të siguruar informacionet e detajuara. Megjithatë, është e qartë se kurdoherë ka probleme për personat e trafikuar, ka të ngjarë që ato shumëfishohen në rastet e viktimave të mitura. Për shembull, procedurat ligjore janë më frikësuese për fëmijët, dhe ka ende më shumë nevojë për këshillimin dhe përfaqësimin ligjor që ata të mund të kuptojnë sistemin ligjor dhe të drejtat e tyre. Ka dhe çështje të tjera të lidhura vetëm me fëmijët, si për shembull nevoja për sisteme efektive të punës sociale dhe kujdestarisë, me qëllim sigurimin se dhënia dhe shpenzimi i parave të dëmshpërblimit do të monitorohen dhe se fëmijët do të mbrohen nga prindërit ose kujdestarët në qoftë se veprimet e tyre nuk përkojnë me interesat më të larta të fëmijës.

Si përfundim, ndërsa mekanizmat e dëmshpërblimit ekzistojnë në të gjitha vendet e këtij studimi, vetëm një numër shumë i vogël i personave të trafikuar kanë kërkuar dëmshpërblimin dhe u është dhënë vendimi për këtë, dhe një numër edhe më i vogël kanë marrë pagesën e dëmshpërblimit të vendosur. Ndonëse mund të jetë e pashmangshme që shumica e personave të trafikuar nuk do të ngrenë kurrë padi për dëmshpërblim dhe nuk do të marrin kurrë dëmshpërblim, megjithatë ka një sërë barrierash që mund të hiqen në mënyrë që të përmirësohet realizimi i kësaj së drejte.

Gjithashtu shtetet mund të bëjnë shumë për të përmirësuar mundësinë e përfitimit duke ofruar që disa metoda janë të disponueshme për të siguruar që dëmshpërblimi mund të përfitohet nga të gjitha llojet e personave të trafikuar.

Në të ardhmen, shtetet duhet të rishikojnë mekanizmat e tyre aktualë për dëmshpërblimin dhe të përcaktojnë nëse po jepet nëpërmjet tyre drejtësia për personat e trafikuar. Në këtë drejtim, cilësitë më pozitive të skemave ose praktikave të vendeve të tjera mund të shërbejnë në disa vende për përmirësimin e metodave ekzistuese. Shtete, gjithashtu, duhet të hartojnë politika mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar, bazuar në konsultime me vetë individët dhe OJF-të që përfaqësojnë interesat e tyre. Masat mund të përfshijnë reforma ligjore dhe institucionale në fushat e legjislacionit civil, penal dhe të punës, në mënyrë që të

përmirësohet mundësia për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë, si dhe sigurimi i asistencës ligjore për personat e trafikuar; sigurimi i informacionit dhe shërbimeve mbështetëse për personat e trafikuar; mundësia për personat e trafikuar që të rregullojnë statusin e tyre gjatë kohëzgjatjes së padisë; forcimi i kompetencave të inspektoriateve të punës dhe të organizmave të ngjashëm për të lëshuar urdhra, përfshirë shpërblimin e dëmit; dhe shqyrtimi i sistemeve jashtëgjyqësore për të negociuar pagesat, si për shembull ndërmjetësimi.

OJF-të dhe sindikatat duhet të vazhdojnë rolin e tyre të rëndësishëm nëpërmjet vlerësimit të legjislacionit civil, penal dhe të punës në vendet e tyre dhe të hartimit të strategjive për avancimin e interesave të viktimave për të përmirësuar mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit dhe të mjeteve të tjera mbrojtëse, si dhe nëpërmjet asistencës për ndërmjetësim. OJF-të që punojnë në fushën e trafikimit mund të përfitojnë nga bashkëpunimi me grupet e tjera që punojnë me viktimat e trafikimit, me të drejtat e emigrantëve dhe me të drejtat e punëtorëve, meqenëse të gjithë këto grupe kanë këndvështrime të dobishme rreth kësaj teme.

Shqipëria, Franca, Moldavia, Rumania, Federata Ruse, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Analiza në raportin përqendrohet në çështjen se si personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar mund të përfitojnë dëmshpërblim nëpërmjet proceseve civile, penale dhe të punës apo nëpërmjet skemave shtetërore të dëmshpërblimit në secilin prej këtyre vendeve. Raporti synon të identifikojë praktika të mira dhe të paraqesë rekomandime për veprime të ardhshme.

Pjesa 2 trajton standardet ndërkombëtare në lidhje me dëmshpërblimin, dhe detaje të mëtejshme jepen në Shtojcat. Pjesa 3 bën një rishikim të mekanizmave të dëmshpërblimit në bazë të padive ndaj trafikantëve ose shfrytëzuesve, ose nga shteti, si dhe faktorët që ndikojnë në efikasitetin e tyre. Në këtë pjesë shqyrtohet se si llojet e humbjeve të pretenduara mund të ndikojnë në rezultatin e kërkesës; rëndësia e procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të konfiskimit të pasurisë; ndikimi i çështjeve ndërkombëtare në suksesin e kërkesave; dhe nevoja për një funksionim të mirë të shtetit të së drejtës. Këtu dalin në pah dhe ndryshimet kryesore dhe ngjashmëritë mes sistemeve dhe disa prej problemeve të veçanta me të cilat ndeshen personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në paraqitjen e kërkesave. Pjesa 4 trajton rolin e rëndësishëm të komunitetit të OJF-ve në mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar dhe në ofrimin e shërbimeve. Pjesa 5 përmban profilet e vendeve, ku përfshihen një përmbledhje e kuadrit ligjor dhe institucional kombëtar; funksionimi i skemave shtetërore, dëmshpërblimi nëpërmjet proceseve civile, penale dhe të së drejtës së punës; sekuestrimi i pasurisë; dhe ndihma ndaj personave të trafikuar në secilin vend të studiuar. Profilet e vendeve theksojnë dhe praktika të mira. Pjesa 6 përfundon me rekomandimet për veprime të ardhshme.

1.2 METODOLOGJIA

Ky studim bazohet në një analizë studimore të ligjeve, raporteve të rasteve dhe burimeve dytësore mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar. Raportet, këshillimi dhe kontributet janë marrë nga përfaqësues të misioneve të OSBE-së, prokuroritë, OJF-të, avokatët e viktimave dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë për të drejtat e personave të trafikuar, të drejtat e emigrantëve, të drejtat e viktimave të krimit dhe të drejtat e punëtorëve. Disa prej përgjigjeve bazohen në një pyetësor standard, disa të tjera janë marrë nëpërmjet intervistave dhe komunikimit me studiuesit. Ky raport u paraqit si dokument për diskutim në seminarin e OSBE/ODIHR-it mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar, zhvilluar në Barcelonë në dhjetor të vitit 2007. Në seminar u dhanë komente dhe sugjerime mbi dokumentin dhe më pas shumë prej pjesëmarrësve dhanë komente me shkrim. Këto komente dhe sugjerime janë integruar në raport.

punëtorëve emigrantë dhe të drejtave të viktimave të krimit, të cilat janë të gjitha të rëndësishme për këtë studim.[8] E drejta e dëmshpërblimit është pranuar si parim edhe nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.[9]

[8] Për një pasqyrim të plotë të standardeve ligjore ndërkombëtare dhe analizë me tabelën e ratifikimeve, shih Shtojcën V. Pavarësisht nga fakti se jo të gjitha standardet janë ratifikuara as nuk zbatohen në të gjitha vendet e përfshira në këtë raport, ato kanë rëndësi në rajonin e OSBE-së.

[9] Shih, p.sh., Gjykata Ndërkombëtare Penale – Statuti i Romës (miratuar më 17 korrik 1998, hyri në fuqi më 1 korrik 2002), neni 75: Zhdëmtimi i viktimave: "1. Gjykata vendos parime në lidhje me zhdëmtimin e viktimave, ose në lidhje me ata, duke përfshirë kthimin e dëmit, dëmshpërblimin dhe rehabilitimin. Mbi këtë bazë, në vendimin e saj me kërkesë të palëve ose me iniciativën e saj në rrethana të veçanta, Gjykata mund të përcaktojë shtrirjen dhe masën e dëmit, humbjes dhe dëmtimit të viktimave ose në lidhje me ata, dhe deklaron parimet mbi të cilat vepron. 2. Gjykata mund të marrë vendim urdhërues ndaj të dënuarit, duke përcaktuar zhdëmtimet e duhura për, ose në lidhje me, viktimat duke përfshirë kthimin e dëmit, dëmshpërblimin dhe rehabilitimin. Kur është e përshtatshme, Gjykata mund të vendosë që zhdëmtimi të bëhet nëpërmjet Fondit të Dedikuar të parashikuar në nenin 79…"

2. Dëmshpërblimi sipas së drejtës ndërkombëtare – një vështrim i përgjithshëm

Ekzistojnë një sërë instrumentesh ndërkombëtarë që mund të përdoren për të mbrojtur të drejtat e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar. Përgjithësisht, instrumentet që mbrojnë viktimat e krimit, personat e trafikuar dhe që merren me punën e detyruar, janë të ratifikuar më gjerësisht se ato që mbrojnë të drejtat e punëtorëve emigrantë. Këto standarde tregojnë se, së bashku me praktikën vendase në rritje, e drejta për dëmshpërblim, ashtu si dhe të drejta të tjera ndihmëse, si ajo e ndihmës ligjore, po njihen më gjerësisht. Zbatimi i së drejtës në një shtet në veçanti varet nëse ai shtet ka ratifikuar konventën përkatëse. Megjithatë, është e rëndësishme për t'u mbajtur mend se këto janë standarde minimale që duhen respektuar dhe se shtetet janë të lira të përfshijnë dispozita të zgjeruara.

2.1 PASQYRIM I TË DREJTËS PËR DËMSHPËRBLIM

Shtetet palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (KKBKON)[10] dhe Protokolli i Trafikimit,[11] janë të detyruara të sigurojnë që të paktën një lloj procedure ligjore është në dispozicion të personave të trafikuar me të cilën mund të përfitohet dëmshpërblimi. Shtetet gjithashtu janë të detyruara të sigurojnë që viktimave u jepet informacionin për këtë mundësi. Sipas KKBKON-së, mundësia e dëmshpërblimit duhet nxitur përtej kufijve.

E drejta e personave të trafikuar për dëmshpërblim përforcohet nga Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (KKEVTQNj),[12] e cila parashikon të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti si për dëmin moral, ashtu edhe për atë material. Ajo gjithashtu parashikon të drejtën e përfitimit nga një skemë shtetërore dëmshpërblimi, duke iu referuar modelit të paraqitur nga Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (KEDVKDh).[13] Vihet më shumë theksi tek të drejtat ndihmëse, si ndihma ligjore falas, të cilat e bëjnë dëmshpërblimin një mundësi efektive dhe praktike.

[10] Miratuar më 15 nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 shtator 2003.
[11] Protokollli për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokolli i Trafikimit). miratuar më 15 nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 shtator 2003. I ratifikuar nga të gjitha vendet e këtij studimi.
[12] Miratuar më 16 maj 2005, hyri në fuqi më 1 shkurt 2008.
[13] Për më shumë informacion për këtë konventë dhe kufizimet e saj, shih në vijim dhe Shtojcën III.

2.2 PËRFUNDIM

Ekziston e drejta e dëmshpërblimit në rastet e trafikimit, krimeve të dhunshme, dhunës ndaj grave, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe kur shkelen standardet ndërkombëtare të punës. Megjithatë, kjo e drejtë kufizohet në dëmshpërblimin nga trafikanti/shfrytëzuesi. Dëmshpërblimi nga shteti ndodh vetëm në rrethana të kufizuara të krimeve të dhunshme që shkaktojnë dëme fizike dhe mendore.

Standardet ndërkombëtare kanë zhvilluar parimin sipas të cilit përfitimet e trafikantëve nëpërmjet aktiviteteve të tyre shfrytëzuese duhet të përdoren në dobi të personave të trafikuar në mënyrë individuale ose kolektive. Udhëzimet ndërkombëtare me natyrë politikisht detyruese paraqesin gjithashtu detyrimin e mbledhjes së pasurive të krimit dhe përdorimin e kësaj pasurie për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Theksohen gjithashtu edhe interesat e veçanta të grave dhe fëmijëve. Kur rasti përmban shkelje shumë të rëndë të të drejtave të njeriut, shkelje të rëndë të ligjeve humanitare apo krim ndërkombëtar (siç përcaktohet nga Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale), atëherë ekziston një theksim akoma më i madh mbi të drejtën për dëmshpërblim.

3. Dëmshpërblimi – kuadri ligjor në vende të ndryshme

Dallimi kryesor midis mekanizmave të ndryshëm të dëmshpërblimit qëndron në faktin nëse dëmshpërblimi i paguhet personit të trafikuar nga shteti apo nga autori i veprës penale. Kjo pjesë e raportit përmban një pasqyrim të mekanizmave ekzistues të dëmshpërblimit dhe sfidat me të cilat ndeshen individët që kërkojnë dëmshpërblim nga të dy burimet. Shqyrtohen gjithashtu edhe sfidat me të cilat përballen personat e trafikuar në kërkimin e dëmshpërblimit. Llojet e humbjeve që dëmshpërblehen nga mekanizma të veçantë ndikojnë në suksesin dhe masën e shpërblimit. Kjo shihet bashkë me domosdoshmërinë për një zbatim efektiv të vendimeve dhe procedurave të konfiskimit të pasurisë. Së fundi, diskutohen dhe ndërlikimet për shkak të problemeve ndërkombëtare dhe mungesës së shtetit të së drejtës.

3.1 MEKANIZMAT E DËMSHPËRBLIMIT

Vendet kanë mënyra të ndryshme dëmshpërblimi të cilat ndryshojnë dhe brenda të njëjtit vend. Justifikimi ligjor (shkaku i ngritjes së padisë) për të kërkuar dëmshpërblim ndryshon sipas rrethanave rregulluese (p.sh., në legjislacionin civil ose atë të punës), llojeve të humbjeve që kompensohen, si dhe mund të ndryshojnë dhe metodat që përdoren për të llogaritur masën e shpërblimit. Gjithashtu, janë të ndryshme dhe procedurat dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e përfitimit nga shpërblimi në varësi të mekanizmit që përdoret. Çdo ndryshim në procedurë apo në standardin ligjor mund të ndikojë në mundësinë e individit për të paraqitur me sukses kërkesën, dhe për këtë arsye secili mekanizëm ka sfidat ose përparësitë e veta.

Duhet theksuar se SHBA-ja është i vetmi vend në këtë studim ku dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit është i detyrueshëm në çështjet penale, ku ekziston një shkak i caktuar për ngritjen e padisë në çështjen civile në lidhje me trafikimin, si dhe ku janë zakonisht të pranueshme kërkesat nga viktimat e trafikimit për dëmshpërblim nga fondet shtetërore për disa lloje humbjesh materiale. E drejta për të përfituar dëmshpërblim ekziston pavarësisht nëse vepra penale e trafikimit klasifikohet si krim i dhunshëm (shiko profilin e vendeve, SHBA-ja, për të dhëna të mëtejshme). Në të gjitha vendet e tjera, personat e trafikuar trajtohen njëlloj si paditësit e tjerë, dhe kërkesa vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit individual. Ky fakt ka pasoja domethënëse në numrin e padive të suksesshme, p.sh., në Mbretërinë e Bashkuar kërkesa për dëmshpërblim nuk shqyrtohet automatikisht në çështjen

Që në fillim, personi i trafikuar mund të dyshojë më të drejtë për ekzistencën e aseteve të disponueshme për të paguar dëmshpërblimin, meqenëse trafikanti mund t'i ketë larguar ose fshehur ato, para procesit ose gjatë ecurisë së tij. Nga ana tjetër, është e mundur që trafikanti t'i ketë shpenzuar të gjithë fondet për shpenzimet ligjore për mbrojtjen kundër padisë civile ose penale, dhe nuk ka më pasuri, siç ndodh në SHBA. Ekziston dhe mundësia që trafikanti të mos ketë pasur kurrë pasuri të mjaftueshme (veçanërisht nëse ka pasur rol të vogël në rrjetin e trafikimit, p.sh, në rekrutim - shih rastet e Ukrainës, ose nëse është një biznes i vogël - shih profilin për SHBA-në.)

Personi i trafikuar mund të vendosë të ngrejë padi nëpërmjet secilit prej proceseve të lartpërmendura, por shpërblimi mund të jetë aq i ulët sa është poshtërues për të ose nuk reflekton humbjet, duke i lënë kështu një ndjenjë padrejtësie (shih për shembull shpërblimet shumë të ulët që jepen në proceset penale në Mbretërinë e Bashkuar, të cilat janë shumë më të ulët se tarifat për dhimbje dhe vuajtje që do të jepeshin në gjykatat civile ose nga skemat shtetërore). Në nivel ndërkombëtar, ka dallime shumë të mëdha në lidhje me përllogaritjen e dëmshpërblimit, masa e të cilit ndryshohet dhe në terma relativë. Sipas këtij studimi, masa e dëmshpërblimit në gjykatat penale e Mbretërisë së Bashkuar është veçanërisht e ulët në krahasim me ato në SHBA dhe Ukrainë.

Kur agjencitë shtetërore, siç janë inspektoriatet e punës, kanë burime të mjaftueshme, ato mund të zbulojnë raste shkeljesh të të drejtave dhe kanë mundësi të negociojnë marrëveshje pajtimi midis punëdhënësve dhe punonjësve apo t'u referojnë gjykatave provat ose rezultatet si dhe kërkesat e individëve ose grupeve, duke ulur kështu presionin mbi ta për ta paraqitur vetë padinë. Gjithashtu, kërkesat për dëmshpërblim që trajtohen nëpërmjet zgjidhjes së negociuar me ndërmjetësim ose nëpërmjet zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes, kanë një mundësi më të madhe që të shlyhen nga shkelësi, meqenëse çështja zgjidhet vullnetarisht në një mjedis jashtëgjyqësor. Skema të tilla shmangin procedimet armiqësore të gjatë dhe të kushtueshëm, si dhe kanë përparësinë se mund të bihet dakord njëherësh për disa persona të trafikuar nëpërmjet veprimeve kolektive, p.sh., një grup të punësuarish në vend që secili të ngrejë padi individuale. Sindikatat, OJF-të, avokatët dhe agjencitë e ndërmjetësimit (si ACAS[36] apo Zyra për Këshillimin e Qytetarëve në Mbretërinë e Bashkuar) kanë luajtur të gjitha një rol domethënës në negocimin e marrëveshjeve të tilla.

Personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar kanë ende nevojë për ndihmë në ndjekjen e kërkesave, por vlen të zhvillohen këta mekanizma edhe në vende që nuk i kanë krijuar ende ata. Zakonisht ekzistojnë në kuadrin e së drejtës civile dhe në atë të punës, me qëllim

[36] http://www.acas.org.uk .

Disa avokatë të personave të trafikuar mund të mendojnë se një skemë e tillë e posaçme është e përshtatshme për rastet e trafikimit, veçanërisht kur duket se janë shumë pengesa dhe shumë vështirësi praktike dhe ligjore për të përfituar dëmshpërblim. Megjithatë, standardet ligjore ndërkombëtare të negociuara nga shtetet nuk e njohin të drejtën e përfitimit nga skema shtetërore për të gjithë personat e trafikuar, ndërsa standardet për terrorizmin janë më të forta.[40] Gjithashtu, nuk del në pah menjëherë justifikimi moral për të veçuar personat e trafikuar dhe jo viktimat e krimeve të tjera të rënda dhe poshtëruese.

Sipas një qasjeje tjetër, ndonëse këto mekanizma me fonde shtetërore janë krijuar kryesisht për të dëmshpërblyer viktimat e krimeve të dhunshme, mund të krijohen dhe sisteme të tjera të ngjashme për viktimat e formave të tjera të shkeljeve (p.sh., për ata që kanë pësuar dëme sipas së drejtës civile apo të punës, ose për punëtorët emigrantë të paligjshëm të cilët nuk kanë asnjë mundësi tjetër për të ngritur padi). Mundësimi i ngritjes së padisë mbi baza të ndryshme nga ajo e "viktimës së krimit" do të parandalonte nevojën e raportimit përpara organeve të policisë, gjë që, për arsye të ndryshme, shumë viktima nuk duan të bëjnë. Kjo, gjithashtu, do të thotë se ato viktima që nuk janë të ndërgjegjshme se janë viktima krimi, por kuptojnë se ndaj tyre është kryer një padrejtësi (p.sh., nuk kanë marrë pagën) mund t'i drejtohen një forumi. Meqenëse në përgjithësi skemat shtetërore kanë më pak kërkesa procedurale, ato përdorën më lehtë nga të gjitha viktimat, veçanërisht viktimat e trafikimit, si dhe kanë përparësinë tjetër që pagesa garantohet. Cilido lloj mekanizmi i financuar nga shteti, i cili fokusohet në viktimat e trafikimit, do të kërkonte procedura identifikimi eficiente dhe të drejta, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe një mekanizëm të pranueshëm për llogaritjen e dëmit (për më shumë rreth dëmeve shih 3.3).

Skemat shtetërore janë gjithashtu të kushtueshme, si në lidhje me kostot administrative dhe me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit (për një pasqyrim të përgjithshëm i buxhetit, shih profilin e Mbretërisë së Bashkuar). Qeveritë mund të parapëlqejnë të investojnë në veprimtari të tjera që synojnë forcimin e shtetit të së drejtës apo ndihmën e përgjithshme ndaj viktimave të trafikimit. Për sa u përket detyrimeve ligjore ndërkombëtare, gjendja është e ndryshme në secilin shtet dhe përparësitë për reforma nuk do të jenë të njëjta. Megjithatë, propozuesit e dëmshpërblimit për personat e trafikuar duhet pa tjetër të kenë parasysh çështjet buxhetore të këtyre skemave, kur vendosin se cilat skema ose reforma do të përkrahin.

[40] Shih. p.sh.. nenin 13 të Konventës Evropiane mbi Parandalimin e Terrorizmit. Konventa u miratua më 16 maj 2005 dhe hyri në fuqi më 1 qershor 2007.

mundur që personat e trafikuar të marrin vendimin e informuar për të drejtat e tyre, me ndikim të ndjeshëm në gatishmërinë tyre për të ngritur padinë.

Gjithashtu, kur viktima vihet në lidhje me shërbimet e këshillimit dhe zyrtarët shtetërorë, është e rëndësishme që zyrtarët shtetërorë të jenë të detyruar me ligj për t'i dhënë informacion viktimës rreth mundësive për dëmshpërblim. Kjo nuk ndodh në Shqipëri, ku me sa dihet nuk janë bërë padi për dëmshpërblim brenda proceseve penale të trafikimit.

Probleme janë hasur dhe në Mbretërinë e Bashkuar, ku viktimat janë kthyer në vendin e origjinës dhe përpjekjet për të mbledhur prova për padinë e tyre vështirësohen nga pengesat gjuhësore dhe burokratike. Është jashtëzakonisht e vështirë që paditë për dëmshpërblim të ndiqen nga jashtë vendit, kështu që do të ishte shumë mirë që në të gjitha vendet e destinacionit të kenë shërbime dhe sisteme që mundësojnë përdorimin e mjeteve për të kërkuar drejtësinë. Kur viktima nuk ka zgjedhje tjetër përveçse të kthehet në vendin e origjinës ose dëshiron të kthehet pa vonesë, duhet siguruar përfaqësimi ligjor në mënyrë që personi të jetë i përfaqësuar në mungesë.

Sistemet ligjore dhe të drejtat zakonisht janë aq të ndërlikuara, sa është i nevojshëm këshillimi dhe përfaqësimi i viktimës nga një avokat. Ky studim tregon se ndonëse ndihma ligjore falas është thelbësore që të përmirësohet mundësia për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë, ajo ofrohet rrallherë. Ndihma ligjore për viktimat e trafikimit ofrohet në disa raste në çështje penale, siç ndodh në SHBA, ose ekziston këshillimi mbi të drejtat e punës por jo përfaqësimi, siç ndodh në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, asnjë shtet nuk u garanton shërbimin gjithëpërfshirës viktimave. Ky fakt thekson rëndësinë e sigurimit të ndihmës ligjore falas, e cila ka aftësi të këshillojë viktimën për të gjitha aspektet e dëmshpërblimit dhe çështjet e lidhura me të. Nga ana tjetër, kjo tregon se mekanizmat e dëmshpërblimit duhet të jenë më pak të ndërlikuar dhe më të lehtë për t'u përdorur, dhe/ose duhen hartuar sisteme alternative më të thjeshtë ose në të cilat viktima nuk ka nevojë të jetë aktori kryesor në ngritjen dhe ndjekjen e padisë.

Për sigurimin e dëmshpërblimit, vështirësi të tjera lindin nga fakti se numri i çështjeve të trafikimit të hetuara është shumë i vogël në krahasim me numrin e viktimave (shih shënim 17). Dhe në rastet kur kryhet hetimi penal, vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, edhe pse e parashikuar në legjislacion, mund të mos jetë vepër penale që hetohet në atë rast të veçantë. Në Francë, është vepra penale e trafikimit ajo që aktivizon të drejtën e dëmshpërblimit nga shteti, por, në të shumtën e rasteve, kjo vepër nuk ndiqet në çështjen penale, por zëvendësohet nga një tjetër që është e afërt.

skemë e tillë mund të zbatohet dhe në vende të tjera dhe në pjesë të tjera të sistemit ligjor dhe rregullator, si, p.sh., në inspektoriatet e punës.

3.3 LLOJET E HUMBJES DHË TË DËMIT

Dëmshpërblimi i paguhet vetëm dikujt që ka pësuar humbje ose dëmtim. Përgjithësisht këto humbje dhe dëme duhen provuar nëpërmjet paraqitjes së provave. Jo gjithmonë përfshihen llojet specifike të humbjes dhe dëmit të pësuar nga personi i trafikuar në kategoritë e dëmit të parashikuara nga skemat ekzistuese të dëmshpërblimit.

Padia për dëmshpërblim e ngritur nga personi i trafikuar zakonisht përmban disa elementë, të cilët ndahen në kategoritë e gjëra të dëmit "moral" (jofinanciar) dhe "material" (financiar) (shih pjesën 1.3, Fjalor). Për shembull, viktima mund të ngrejë padinë për dhimbje dhe vuajtje për shkak të dhunës fizike ose psikologjike (dëmin moral), si dhe shpenzime mjekësore të veçanta (dëme materiale). Megjithatë, ka mundësi që mekanizmi i dëmshpërblimit të rimbursojë vetëm elementin e dëmit material ose të urdhërojë një pagesë vetëm simbolike për dëmin moral.

Për të kryer vlerësimin e dhënies së dëmshpërblimit viktimës, duhet të merren parasysh një sërë faktorësh: natyra dhe masa e humbjes, dëmeve apo plagosjes; nëse këto lloj humbjesh do të paguhen nga mekanizmi ekzistues i dëmshpërblimit; nëse ka masë maksimale ose minimale të dëmshpërblimit; nëse viktima mund të përligjë humbjen me anë të provave si dhe forca bindëse të provave. Këta faktorë ndikojnë në mundësinë e viktimës për të ngritur padi, natyrën e padisë dhe masën e shpërblimit.

Disa skema dëmshpërblimi e kanë të përcaktuar që kompensohet vetëm "dëmi material" ose kufizojnë humbjet e rimbursueshme në disa lloje të përcaktuara të "dëmeve materiale." Për shembull, në Shqipëri, nuk lejohet ngritja e padisë për dëm moral në procedimin civil brenda procesit penal. Në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar, skemat e dëmshpërblimit të subvencionuara nga shteti rimbursojnë vetëm disa lloje të përcaktuara të dëmeve materiale dhe jo të gjitha dëmet materiale (për listat e plota, shih profilet e vendeve, p.sh., në Rumani pagesa e dëmshpërblimit nga skema shtetërore mbulon shpenzimet e shtrimit në spital, shpenzimet mjekësore, shpenzimet e varrimit, dëme ndaj disa lloj sendesh që kanë një vlerë tregu, humbjen e të ardhurave dhe mirëmbajtjen e personave në ngarkim).

Viktimat e trafikimit mund të pësojnë humbje të tjera që nuk përfshihen në kategoritë e parashikuara nga mekanizmat ekzistues të dëmshpërblimit. Këto mund të jenë, p.sh., pagë e

papaguar, “tarifat” që u janë paguar agjencive rekrutimi, “gjobat” e vendosura nga trafikantët për sjellje të keqe, “zbritjet” nga paga që janë të tepërta, mashtruese ose të paligjshme për qiranë, shpenzimet e përditshme, transportin dhe “pagesat” e tatimeve apo të sigurimeve shoqërore. Kategori të tilla të dëmeve materiale të cilat rezultojnë nga shfrytëzimi nuk rimbursohen gjithmonë nga skemat e dëmshpërblimit, që kanë vendosur kufizime të rrepta mbi dëmet materiale që do të paguajnë. Këto kufizime rrjedhin nga qëllimi fillestar i këtyre skemave, i cili ishte dëmshpërblimi i dëmeve nga krimet e dhunës, dhe nuk janë ndryshuar që të trajtojnë dhe faktet e ndërlikuara që mund të paraqesë një rast trafikimi.

Shpërblimi i dëmit material zakonisht pasqyron humbjen e pretenduar të pësuar në fakt, por normalisht masa e dëmit duhet provuar me anë të dëshmive, faturave ose dokumentacionit tjetër. Personat e trafikuar në shumicën dërrmuese të rasteve do të kenë vështirësi të provojnë dëmin e tyre material, veçanërisht nëse dëmi ka lindur përgjatë kohës së trafikimit.[47] Për këtë arsye, është e rëndësishme që skemat e dëmshpërblimit të pranojnë deklaratat me shkrim ose me gojë të viktimës si provë të mjaftueshme për të provuar padinë (shih për shembull Ukrainën, ku kërkohen prova të dokumentuara me shkrim, dhe krahaso SHBA-në, ku dëshmia me gojë mjafton). Për shkak të kësaj nevoje madhore për të siguruar prova, ka një OJF e cila këshillon ata që merren me këshillin e emigrantëve pa dokumente, që t’i ndihmojnë me gjetjen e mënyrave origjinale për sigurimin e këtyre provave nëpërmjet fotografive dhe përshkrimeve të vendit të punës, gjetjes së dëshmitarëve, dhe sigurimit të uniformave dhe pajisjeve të tjera me të cilat është pajisur punëtori.[48]

“Dëmi moral” përcaktohet dhe llogaritet në mënyra të ndryshme në sisteme të ndryshme ligjore. Për shembull, dëmet e tilla llogariten në bazë të udhëzimeve që u jepen gjyqtarëve nga ligjvënësit në Mbretërinë e Bashkuar, nëpërmjet ‘precedente’ (vendime gjyqësore të mëparshme) (Mbretëri e Bashkuar dhe SHBA), pa u dhënë udhëzime apo pa pasur përputhshmëri midis tyre (shih Moldavinë dhe Ukrainën). Në Rumani dhe në vende të tjera në tranzicion nga komunizmi, ky koncept është ende mjaft i pazhvilluar dhe vetëm së fundi është rifutur në kodet civile. Ashtu si dhe me dëmin material, kategoritë e posaçme të dëmit moral dhe natyra e provave që kërkohen për t’i provuar ato, ndryshojnë sipas vendeve dhe skemave të kompensimit. Pothuajse gjithmonë “dhimbja dhe vuajtja” të shkaktuara nga dëmi fizik apo psikologjik duhen provuar me anë të një raporti mjekësor ose psikiatrik, të cilin viktima është e detyruar ta sigurojnë vetë ose me anë të ndihmës ligjore apo nëpërmjet

[47] V. cit., shënimi 18, PICUM, Dhjetë Mënyra, f. 74-75.
[48] Po aty, f. 90.

është shqyrtuar në SHBA. Për shembull, në SHBA, sipas dispozitave mbi kthimin e detyrueshëm të dëmit të parashikuara në ligjin për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, shpërblim penal për pagat e humbura llogaritet si më i madhi i këtyre dy shifrave: "të ardhurat neto ose vlera për të pandehurin e shërbimeve apo të punës së viktimës, ose vlera e punës së garantuar të viktimës," në mënyrë që këto dy teori dëmshpërblimi për pagat e humbura përfshijnë një pasqyrim të vlerës së punës së viktimës për të pandehurin.

Në ngritjen e padisë, viktima e trafikimit ka nevojë për këshillim për përzgjedhjen e të gjitha llojeve të humbjeve që ka pësuar ajo si dhe mënyrat për të siguruar prova për këto humbje. Skemat e dëmshpërblimit mund të mos e kthejnë të gjithë shumën, sepse ato mund të kenë kufizime për llojet e dëmeve që shpërblehen dhe për mënyrën e përllogaritjes së tyre. Disa skema mund të kryejnë vetëm shpërblime simbolike të cilat nuk pasqyrojnë humbjet faktike, ndërsa skema të tjera mund të japin vetëm shuma fikse për disa lloje veprash penale (shih Mbretërinë e Bashkuar). Skema shtetërore mund të jetë më efikase kur masa e dëmshpërblimit përcaktohet nga tarifat e caktuara, ndonëse viktima nuk mendon se në këtë mënyrë pasqyrohen drejt humbjet e pësuara.

3.4 EKZEKUTIMI I VENDIMIT DHE SEKUESTRIMI I PASURISË

Kur lëshohet urdhri që dëmshpërblimi të kryhet nga autori i veprës penale, shpesh duhen marrë masa për të siguruar që do të kryhet pagesa. Në rastet kur padia ngrihet kundër një pale të siguruar, për shembull kundër punëdhënësit apo një të pandehuri "me xhepat plot," si për shembull një 'biznesmen' i pasur, mundësitë që pagesa të kryhet janë të mëdha dhe mund të mos jetë nevoja për ndërhyrjen e përmbarimit. Megjithatë, masat për sekuestrimin e pasurisë që në fazën fillestare të hetimit apo gjatë padisë civile mund të jenë me rëndësi në sigurimin e pagesës.

Kur i pandehuri refuzon të paguajë dëmshpërblim në mënyrë vullnetare, atëherë është nevoja e ekzekutimit të urdhrit për të siguruar pagesën. Teknikat e mbledhjes dhe të ekzekutimit kanë ndikim dhe efikasitet të ndryshëm, në varësi të rrethanave të çështjes dhe të të pandehurit (p.sh., nëse ka në zotërim prona që mund të sekuestrohen) dhe në varësi të teknikës së përdorur, për shembull, mund të ndërmerren masa të tjera penale kur nuk kryhet pagesa e vendosur nga gjykata në çështjen penale (shih Mbretërinë e Bashkuar), mund të merren masa për ta zbritur shumën nga paga apo pagesa e sigurimeve shoqërore në burim (shih Francën dhe Mbretërinë e Bashkuar), ose ndërhyn organ ekzekutues si përmbarimi për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, duke llogaritur vlerën e saj (shumica e vendeve).

Në Francë ka pasur një rast kur gjykata e ka mbajtur shumën ekuivalente të dëmshpërblimit të parashikuar gjatë gjykimit të padisë civile, si garanci për lirimin me kusht në çështjen penale. Në asnjë prej vendeve të këtij studimi, nuk monitorohet sistematikisht përqindja e rasteve të suksesshme të ekzekutimit të urdhrave të gjykatës. Mënyra të ndryshme përdoren në vende të ndryshme.

Vetë viktimat duhen të marrin masa për ekzekutimin e urdhrave, sepse kjo shihet si çështje e së drejtës private (si në Francë). Kjo mund dhe të jetë e kushtueshme. Veprime të tilla mund edhe të jenë të pamundura për viktimat, po të kemi parasysh kërkesat proceduriale dhe ligjore të nevojshme. Përgjithësisht, organet e ngarkuara me zbatimin e vendimit janë të shkëputura nga gjykatat që marrin atë. Për shkak të burokracisë dhe të shpenzimeve për ekzekutimin e urdhrit, realizimi mund të jetë i pamundur dhe në fund të fundit, viktima mund të mos marrë fare shpërblimin.

Masat për ekzekutimin e urdhrit nuk janë të nevojshme, kur pasuritë janë të bllokuara apo të sekuestruara që në fillim të çështjes. Legjislacioni për bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive është i ndërlikuar. Ekzistojnë masa me karakter detyrues për vendet anëtare të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Krimin e Organizuar Ndërkombëtar "në masën më të lartë të mundshme në sistemin ligjor vendas"[51] në lidhje me hetimin penal të krimeve që janë të rënda, ndërkombëtare dhe të organizuara, në përkufizimin e Konventës.[52] Legjislacioni civil dhe ai penal zakonisht përcaktojnë kompetenca të veçanta për zbulimin dhe bllokimin e pasurisë që në fillim të çështjes dhe më vonë për konfiskimin e pasurive nëse provohet akuza.

Në disa vende, shteti është tashmë i autorizuar të kryejë sekuestrimin e pasurisë në fillim të çështjes penale (siç ndodh në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar). Kështu, mund të përdoret autoriteti i plotë i shtetit për të gjurmuar pasuritë e të pandehurit, duke përfshirë informacionin e siguruar nga i pandehuri si dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit. Megjithatë, dobia e këtij autoriteti mund të kufizohet nga një sërë faktorësh, që përfshijnë: shkallën e aftësisë dhe të vullnetit të zyrtarëve shtetërorë për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë; efikasitetin e të dhënave zyrtare në lidhje me, p.sh., llogaritë bankare, aksionet dhe pronat; ekzistencën dhe funksionimin e legjislacionit vendas në lidhje me pastrimin e parave; shpenzimet dhe vlerën relative të përpjekjeve në një rast të veçantë, shkallën e ushtrimit të këtij autoriteti brenda parametrave të të drejtave legjitime njerëzore dhe civile të të pandehurit. Çështja e konfiskimit të pasurisë duhet parë edhe nën këndvështrimin e të

[51] Neni 12.
[52] Neni 3.

mbështetëse për viktimat ose për rehabilitimin (shih pjesën 3). Kjo mund të kryhet në forma të ndryshme, p.sh., krijimi apo kontribuimi në një fond të përgjithshëm për dëmshpërblimin e të gjitha viktimave të krimit; krijimi apo kontribuimin në një fond të pasurive të trafikantëve për të gjithë personat e trafikuar; përdorimi i pasurive të një trafikanti të veçantë për dëmshpërblimin e viktimave të këtij trafikanti; përdorimi i fondeve për mbështetjen e personave të trafikuar apo viktimave të krimit në përgjithësi, apo cilido kombinim i atyre të sipërpërmendura. Megjithatë, duhet theksuar se krijimi i një skeme për mbështetjen e përgjithshme të viktimave nuk është në përputhje me kërkesat ligjore ndërkombëtare për një mekanizëm efikas dëmshpërblimi për viktimën e veçantë.

Në fund të fundit, këto çështje kanë kuptim vetëm kur i pandehuri ka pasuri ose ka gjase se do ta ketë në të ardhmen (periudha e ekzekutimit të vendimit të gjykatës), megjithëse kjo varet nga teknikat vendase për mbledhjen e pasurisë. Në Francë, ligji lejon që dëmshpërblimi të paguhet nga paga ose shumat që i pandehuri merr nga shteti gjatë kohës së burgimit.

Asnjë nga vendet e vëzhguara për këtë studim nuk ka arritur të sigurojë praktika gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi të pasurisë që të sigurojnë pagesën e dëmshpërblimit për viktimat dhe as të krijojnë fonde shtetërore për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. (Në Mbretërinë e Bashkuar, një agjenci qeveritare me profilin e lartë përgjegjëse për konfiskimin e pasurive të zëna si rezultat i veprimtarisë kriminale është kritikuar ashpër se nuk ka arritur të bëjë punën e saj dhe se nuk justifikon paratë e shpenzuara për të – shih profilin e Mbretërisë së Bashkuar). As nuk janë ekzekutuar vendimet për shpërblimin e dëmit për shkak të procedurave të dobëta për ekzekutimin, të kompetencave për sekuestrim që janë të munguara, të dobëta ose që nuk ushtrohen siç duhet, ose të për të dy arsyet. Është teknikisht dhe praktikisht e vështirë që të bëhen përmirësime në këto drejtime si dhe kjo varet dhe nga funksionimi i shtetit të së drejtës dhe nga kushtet buxhetore. Megjithatë, këto çështje janë ngritur këtu sepse janë të lidhura ngushtë me zbatimin efektiv të mekanizmave të dëmshpërblimit.

3.5 SFIDAT E KËRKESAVE PËR DËMSHPËRBLIM PËRTEJ KUFIJVE DHE ÇËSHTJEVE TË JURIDIKSIONIT

Natyra ndërkombëtare e trafikimit të qenieve njerëzore paraqet sfida të veçanta. Viktimat që kanë ndryshuar juridiksion nga ai ku është kryer krimi ose nga ai ku janë identifikuar si persona të trafikuar, përballen me vështirësi të qarta praktike në ndjekjen e padisë për dëmshpërblim përtej kufijve. Vështirësi hasen dhe kur trafikanti transferohet në një juridiksion tjetër për hetim dhe gjykim, apo kur pasuria e një krimineli ose e një të

gjatë kohëzgjatjes së padisë (shih SHBA-në), megjithëse s'duhet harruar se viktima mund të dëshirojë të kthehet në vendin e vet dhe më vonë mund të vendosë të ngrejë padinë.

Kur viktima riatdhesohet brenda një kohe të shkurtër pas marrjes së pagesës, mund të ketë nevojë për ndihmë në transferimin dhe investimin e parave. Kjo mund të jetë veçanërisht e vështirë, kur viktima është e mitur dhe do të ketë mbrojtje të kufizuar kur të kthehet në vendin e vet.

OJF-të që merren me procesin e riintegrimit mund të përqendrojnë përpjekjet në mbledhjen e informacionit dhe të njohurive të duhura për të ndihmuar viktimat, dhe vendet e origjinës mund të përpiqen të krijojnë lidhje institucionale me organet që mbështesin viktimat në vendet e destinacionit, në mënyrë që të sigurojnë informacion dhe të mbështesin paditësit.

Në rastet kur një i pandehur është ekstraduar ose transferuar në një juridiksion tjetër për ndjekjen e çështjes, ka të ngjarë që pasuria i tij të ketë vendndodhje tjetër, dhe për zbatimin e çdo urdhri dëmshpërblimi do të jetë i nevojshëm bashkëpunimi ndërkufitar sipas KKBKON-së.[60] Viktimat gjithashtu rrezikojnë mundësinë për të ngritur padinë civile në procesin penal apo padinë për dëmshpërblim, nëse çështja gjykohet në një vend tjetër, përveç rasteve kur marrin ndihmë të specializuar për ndjekjen e hapave ligjorë. Vështirësitë rriten kur çështja, e cila është në gjykim e sipër jashtë, nuk bazohet në disa fakte ose të gjitha faktet e çështjes së viktimës (p.sh., nëse ka dhe viktima të tjera ose prova të krimeve që nuk kanë lidhje me krimin që prek viktimën).
Këto lloj faktorësh kompleksë në lidhje me zbatimin e ligjit ekzistojnë në të gjitha çështjet penale të trafikimit të cilat kalojnë kufijtë, dhe janë gjithnjë të vështira. Për këtë arsye, është thelbësore që të vendosen marrëdhënie të mira të komunikimit ndërmjet agjencive shtetërore dhe OJF-ve në vendet e origjinës dhe të destinacionit. Megjithatë, marrëdhëniet duhet të shtrihen, në mënyrë që të përfshijnë bashkëpunimin në lidhje me të gjitha të drejtat e viktimës, duke përfshirë kërkesën për dëmshpërblim në çdo drejtim, dhe të mos kufizohen vetëm në fushën e zbatimit të legjislacionit penal. Kjo theksohet në detyrimet sipas nenit 25(2) të KKBKON-së, i cili gjithashtu nxit lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe në çështje të tjera të ndihmës ndërsjellë ligjore.

3.6 SHTETI I SË DREJTËS

Mekanizmi i dëmshpërblimit nuk mund të funksionojë më mirë se mjedisi i përgjithshëm juridik. Meqenëse mekanizmat e dëmshpërblimit në thelb bazohen në sistemet e rregullave

[60] Nenet 12, 13, 14 dhe 18.

dhe procedurave të administruara nga gjyqësori ose nëpunësit civilë, efikasiteti i tyre lidhet me funksionimin e shtetit të së drejtës në vendin e caktuar. Kur ka probleme me pavarësinë, aftësinë apo integritetin e aktorëve shtetërorë, vihet në rrezik realizimi i së drejtës për të marrë dëmshpërblim. Viktimat nuk do të kenë besimin e nevojshëm tek drejtësia për të ngritur një padi. Gjithashtu, probleme të rrënjosura thellë në vende të caktuara, si procedura civile të tejzgjatura (që zgjasin për vite në disa vende), ndikojnë në efikasitetin e skemave të dëmshpërblimit. Në vende ku probleme të tilla janë të mirëfillta, duke parashtruar sfida praktike në kuadrin kombëtar, reforma ligjore ose institucionale e përqendruar në përmirësimin e mekanizmit të dëmshpërblimit mund te jenë të kotë, dhe probleme thelbësore mund të kërkojë zgjidhje të tjera të cilat nuk lidhen me dëmshpërblim.

Në disa raste, mosfunksionimi i mekanizmit të dëmshpërblimit për personat e trafikuar thjesht rezulton nga mungesa e informacionit nga ana e prokurorëve që merren me çështjet e trafikimit (në Francë, ndryshe nga SHBA-ja, vetëm së fundi trafikimi njihet si vepër penale) ose përdorimi i një koncepti të ri ose kompetence të re nga ana e policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve (p.sh., dëmi moral në Rumani apo konfiskimi i pasurisë në Shqipëri). Në të gjitha juridiksionet, ndryshimet ligjore nuk kanë një ndikim të menjëhershëm në praktikën, dhe ndonjëherë ka vonesa në marrjen e masave praktike për zbatimin e tyre (p.sh., trajnimi i gjyqtarëve, udhëzimet për prokurorinë). Në këto rrethana, ONQ-të dhe OJF-të nëpërmjet aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve mund t'u vijnë në ndihmë vendeve që nuk kanë traditën përkatëse juridike. Megjithatë, duhen përshtatur në masën e duhur pritshmëritë e arritjeve të mundshme në periudha të shkurtra kohore, shpesh me burime të kufizuara dhe mungesa të përvojave vendase.

Së fundi, sfidat e përmirësimit të sistemit të përgjithshëm ligjesh dhe procedurash (p.sh., sistemi i padisë civile brenda procesit penal) mund të jenë veçanërisht të vështira, nëse ndryshimet nxiten vetëm nga një institucion shtetëror. Nevojiten një sërë aktorësh të angazhuar që kërkojnë reformën apo ndërtimin e mekanizmit të dëmshpërblimit (p.sh., duke përfshirë ministritë e drejtësisë dhe të brendshme, si dhe gjyqësorin) dhe jo thjesht organi shtetëror që merret me çështjet e trafikimit.

3.7 PËRFUNDIM

Ekzistojnë mundësi të ndryshme në vende të ndryshme për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Në më të shumtën e rasteve, dëmshpërblimi kryhet nëpërmjet procesit penal ose nëpërmjet skemës shtetërore për viktimat e dhunës. Përdoren më pak, dhe njihen më pak, paditë e veçanta për dëmshpërblim në procesin civil apo në procesin sipas legjislacionit të punës.

Ekzistojnë sfida konkrete ligjore dhe procedurale (p.sh., kriteret mbi mundësinë e përfitimit, kohëzgjatja e proceseve, kërkesa për ndihmën ligjore, ekzistenca e llojeve të caktuara dëmi), që do të thotë se të gjithë sistemet në shumicën e rasteve dështojnë në dhënien e dëmshpërblimit për personat e trafikuar. Kështu ndodh si në kërkesën e dëmshpërblimit nga keqbërësi ashtu dhe nga shteti. Ka shumë mundësi që personat e trafikuar nuk do të kenë të drejtë përfitimi nga sistemet ekzistuese, ndonëse në dukje mekanizmat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të dëmshpërblimit. Vështirësitë me të cilat ndeshet cilido person që u drejtohet organeve të drejtësisë, rriten në rastin e personave të trafikuar, të cilët, ndër faktorë të tjerë, mund të mos kenë status ligjor në vendin ku ngrenë padinë, mund të hasin pengesa gjuhësore dhe mund të kenë ndrojtje ta ndjekin çështjen për shkak të procedurave ose të frikës së trafikantit/shfrytëzuesit.

Në çështjet e dëmshpërblimit në të cilat jepen vendimet gjyqësore për pagesën, paraqiten gjithashtu sfida në lidhje me mbledhjen joefektive të pasurive dhe me teknikat e zbatimit të vendimit që nuk funksionojnë mirë në lidhje me sekuestrimin e pasurive. Sfida të tjera përfshijnë vështirësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe vështirësitë me të cilat ndeshen mekanizmat e dëmshpërblimit për shkak të mungesës së përgjithshme të shtetit të së drejtës.

Si rezultat i këtyre problemeve, paditë kolektive, zgjidhjet e ndërmjetësuara dhe paditë e ngritura nga shteti kundër punëdhënësve (p.sh., nga inspektoriatet e punës) mund të kenë më shumë mundësi sesa paditë individuale për të siguruar pagesën e dëmshpërblimit për personin e trafikuar, veçanërisht në rastet e shfrytëzimit për punë. Kërkimi i dëmshpërblimit nga skemat shtetërore do të kenë më shumë sukses në qoftë se rishikohen kriteret e së drejtës për të përfituar nga ato, në mënyrë që të merren parasysh rrethanat e veçanta të personave të trafikuar. Mundësi të tjera përfshijnë edhe krijimin e fondeve të veçanta për personat e trafikuar.

sepse shteti ligjor është i dobët ose ka korrupsionin ose thjesht mungesën e lehtësirave të duhura.[81]

4.3 PËRFUNDIME

Pa veprimtarinë e shoqërisë civile, e drejta për dëmshpërblim e viktimave të krimit në përgjithësi, dhe të personave të trafikuar në veçanti, nuk do të ishte krijuar as nuk do të ishte zbatuar në mënyrë aq të mirë. OJF-të mund të jenë forca shtytëse kryesore për të nxitur qeveritë të bëjnë ndryshimet e nevojshme. Në përgjithësi, përpjekjet për përkrahjen e të drejtave të viktimave dhe të drejtën e dëmshpërblimit janë bërë nga një sërë organizatash, ndonjëherë të ndara, sepse përqendrojnë në interesa të ndryshme. Kjo do të thotë, që ato nuk janë të ndërgjegjësuara në çdo rast për faktin që interesat e ndërsjella janë të lidhura me njëri-tjetrën apo se si përfituesit e secilës organizate mund të përfitojnë nga njohuritë dhe përvoja që kanë mbledhur OJF-të e tjera. Do të ishte e vlefshme për OJF-të që të ndërmerrnin veprimtari të përbashkëta për grupet e ndryshme të interesit të cilat merren me temën e dëmshpërblimit, këshillimit e viktimave dhe ndihmës ndaj tyre, si dhe që të nxisnin veprimtari të përbashkëta të tilla.

[81] Po aty, f.282-283.

që kanë, varet nga fakti nëse ato këshillohen nga OJF-të. Është e nevojshme që viktimat t'i njohin të drejtat e tyre sa më parë të jetë e mundur, në mënyrë që të merren masat për të hartuar kërkesëpadi të vlefshme. Pavarësisht nga kufizimet aktuale të dëmeve që mund të kërkohen, viktima mund të paraqesë kërkesë, p.sh., për fitimet "e fituara padrejtësisht" nga trafikanti, për të cilat ajo nuk ka qenë në dijeni.

Kodi i Procedurës Penale nuk i atribuon të drejta të qarta viktimës. Vetëm nëse merr statusin e paditësit civil në procesin penal, ajo ka të drejtë të përfaqësohet. Si rrjedhojë, njohja e përgjithshme dhe roli i viktimës në procesin penal është i mangët (p.sh., nuk ka të drejtë t'u drejtojë pyetje dëshmitarëve), dhe kjo mund të sjellë pasoja në praktikë ku të drejtat e viktimës nuk merren seriozisht nga policia, nga prokuroria ose nga vetë gjykata. Edhe në rastet kur viktima ka përfaqësim ligjor, përfaqësuesit kanë shumë pak të drejta ligjore për të kërkuar në emrin e klientëve.

Në kushtet e mungesës së informacionit në lidhje me paditë civile në procesin penal, është e pamundur që të bëhet një vlerësim i nivelit të ekzekutimit të vendimeve. Megjithatë, duke pasur parasysh dobësitë në garantimin e gjykimit efektiv të padisë civile, ka të ngjarë që dhe mekanizmat e ekzekutimit të vendimeve të jenë po aq të dobët.

Kodi Civil parashikon ngritjen e padisë civile në procesin penal në rastet kur individi është dëmtuar nga vepra penale.[107] Të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës civile e kanë dhe të huajt.[108] E drejta për shpërblim të dëmit material (pasuror) në dukje përbëhet si vijon:[109]

"a) i pandehuri shpërblen "dëmin e pësuar" dhe "fitimin e munguar";
b) shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur dëmin ose për të pakësuar atë;
c) shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore;
ç) detyrimi të shpërblejë dëmin që i pandehuri ka shkaktuar ndaj shëndetit të tjetrit, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësinë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij si dhe shpenzime të tjera që janë bërë në lidhje me dëmin e shkaktuar" (Sipas nenit 641 dhe nenit 642, duket se masa e shpërblimit të dëmit mund të rritet në të ardhmen në rast të rëndimit të shëndetit);
d) kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmet që duhet të shpërblehen përbëhen nga: shpenzime për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur,

[107] Neni 608.
[108] Neni 3.
[109] Nenet 640-644 të Kodit Civil.

5.1.2.4 Ndihma për viktimat

As policia, as prokuroria dhe as gjykata nuk kanë detyrim të informojnë dhe të këshillojnë viktimat e krimit në lidhje me të drejtat e tyre. Pra dhe kjo nuk do të ndodhë, sipas të gjitha gjasave, përveç rasteve kur viktimat informohen nga një palë e pavarur. Kur viktima merr pjesë në procesin penal si paditës civil, ka të drejtë të përfaqësohet nga një avokat mbrojtës, duke qenë se është palë në proces.[119] Megjithatë, fakti që nuk ka asistencë ligjore të paguar ose të subvencionuar mund të ndalojë përdorimin e përfaqësimit ligjor nga viktimat, përveç rasteve kur ofrohet vullnetarisht nga OJF-të.

Të paktën një OJF, QNLQ, merret me këshillimin e personave të trafikuar, por me sa duket kjo nuk është pjesë e një sistemi referimi të sanksionuar nga shteti. IOM-i ofron asistencë ligjore falas në qendrën kombëtare pritëse, dhe OJF-ja "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" drejton një strehëz. Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si QNLQ apo Klinika Ligjore për të Mitur. Për këto dy organizata, thuhet se ofrojnë shërbim cilësor meqenëse të dyja kanë përvojë në këshillim ligjor. Është shumë e rëndësishme që ndihma ligjore të përfshijë edhe përfaqësimin ligjor dhe që kjo e drejtë të pasqyrohet në Kodin e Procedurës Penale.

5.1.3 Përfundime për Shqipërinë

Mekanizmat aktualë për dëmshpërblimin e viktimave të krimit, në veçanti të trafikimit, janë jashtëzakonisht të dobët. Nuk ka skemë të financuar ose të subvencionuar nga shteti, as plane të dukshme për të ngritur një skemë të tillë, pavarësisht nga ratifikimi i Konventës Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme. Për të krijuar një sistem më të thjeshtësuar, duhet shqyrtuar mundësia e zbatimit të një skeme dëmshpërblimi të financuar nga pasuria e kriminelëve dhe/ose fondet shtetërore. Kjo gjithashtu do të mundësonte personat e trafikuar që kanë identifikuar ose gjetur vendndodhjen e të pandehurit të paraqesin kërkesë kundër tyre.

Viktima ka të drejtë të kërkojë dëmet materiale si paditës civil në procesin penal, por në të vërtetë ajo nuk këshillohet paraprakisht për këtë dhe mesa duket e drejta ushtrohet rrallë. Një rast i kohëve të fundit shënon një hap të vogël përpara në lidhje me vullnetin e mirë të gjykatave për të gjykuar padinë dhe për të dhënë dëmin material. Megjithatë, këto probleme kanë një ndikim të përgjithshëm mbi të drejtat e personave të trafikuar në Shqipëri, dhe është e nevojshme që Koordinatori Kombëtar të monitorojë nga afër paditë civile për

[119] Neni 67 i KPrP.

qëllimet e elementit të mbrojtjes së dëshmitarëve është edhe pasurimi i shërbimeve për mbrojtjen e viktimës, duke përfshirë këshillimin përgjatë procesit ligjor.

Ekziston një komunitet aktiv OJF-sh që punojnë për të ofruar ndihmë efikase dhe mbështetje ndaj personave të trafikuar. Këtu përfshihen La Strada, Komiteti për Parandalimin e Trafikimit të Grave dhe një strehëz e IOM-it. Ato merren edhe me mbrojtje ligjore, me studime dhe zbatime të shërbimeve për personat e trafikuar përmes një mekanizmi referimi.

5.3.2. Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve

Ligji për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në thelb rithekson të drejtat ekzistuese ligjore për dëmshpërblim dhe nuk shkon më tej se kaq:

> "Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë të drejtë të dëmshpërblehen për dëmet e pësuara, siç parashikohet në ligj."[183]

Megjithatë, Plani i Veprimit Kombëtar për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore[184] synon të vendosë parashikime ligjore për mundësinë e marrjes së dëmshpërblimit nga trafikantët apo nga shteti[185] dhe të garantojë zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që mundësojnë marrjen e dëmshpërblimit.[186] Dëmshpërblimi nga shteti synohet që të arrihet

> "duke rimbushur fondin për shpërblimin e personave të trafikuar me mjete monetare të siguruara nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme prej trafikantëve."

Një synim tjetër është që të:

> "rritet niveli i njohurive të viktimave për sa u takon mundësive të dëmshpërblimit [...duke] u siguruar personave të trafikuar ndihmë ligjore me avokatë në të gjitha shkallët e procesit penal," si dhe "duke u ofruar materiale informuese lidhur me të drejtat dhe mundësitë e marrjes së dëmshpërblimit gjatë procesit penal."

[183] Neni 23(2)
[184] Miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 903, datë 25 gusht 2005 dhe botuar në Monitorin Zyrtar nr.119-122/987, datë 7 shtator 2005.
[185] Paragrafi 1.2(e).
[186] Paragrafi 4.4.

"Viktima" përkufizohet si një person fizik apo juridik që pëson dëme morale, fizike apo materiale si pasojë e një krimi. Kërkohet që viktima të bëjë kërkesë para autoriteteve ligjore me qëllim që të regjistrohet zyrtarisht si viktimë e krimit.[192] (Nuk ekziston ndonjë dispozitë në nivel kombëtar që t'i njohë si viktima personat e lidhur me viktimën kryesore.) Viktimat kanë të drejtë të kërkojnë informacion nga organi i akuzës apo nga gjykata për sa u takon vendimeve që merren në lidhje me të drejtat dhe interesat e tyre.[193]

Gjithashtu, viktimat kanë të drejtë, sipas procedurës penale, të njihen si "palë civile" në një padi civile brenda procesit penal kundër të njëjtit autor.[194] Kjo i mundëson viktimës të kërkojë zhdëmtim për pasoja morale apo materiale të shkaktuara nga krimi dhe çështja.[195] Si palë civile, viktima mund të kërkojë kthim të pronës që i është marrë nga autoritetet me pëlqimin e viktimës për t'u përdorur si provë përgjatë procesit, si dhe kthim të pronës që i është marrë nga autori i krimit.[196]

Gjithashtu, viktimat mund të njihen si "palë e dëmtuar," d.m.th., personi fizik që vuan pasojat morale, fizike apo materiale të shkaktuara nga krimi. Organi i hetimit lëshon një urdhër, në përputhje me ligjin, dhe e njeh personin si palë të dëmtuar menjëherë, pasi ka përcaktuar arsyet për ta bërë këtë kategorizim dhe pasi viktima ka dhënë pëlqimin e saj.[197] Ndërkohë që palës së dëmtuar i njihen këto të drejta të tjera, ajo merr përsipër gjithashtu detyrimin për të bërë deklarata para policisë, prokurorëve dhe gjykatës.

Si palë zyrtarisht pjesëmarrëse në çështjen, palët civile dhe të dëmtuara kanë të drejtën për të bërë deklarata dhe të ngrenë akuza para gjykatës, si dhe të paraqesin dokumente dhe prova të tjera për shqyrtim nga gjykata. Ato kanë të drejtë të kundërshtojnë veprimet e ndërmarra nga organi i hetimit apo gjykata. Gjithashtu, ato lejohen të marrin pjesë në procedimet që lidhen me dëmet.[198]

Pasardhësit përfitues të palëve të dëmtuara ose civile kanë të njëjtat të drejta, ashtu si edhe të viktimat e ndjera.[199] Viktimave që kanë statusin e palëve të dëmtuara ose civile, ose

---

(Megjithatë, këto shifra mund të përfshijnë numërim të dyfishtë, pasi viktimat mund të kenë më shumë se një status në të njëjtën kohë.)
[192] Neni 58(1), (2), Kodi i Procedurës Penale i Moldavisë ("KPrP i Moldavisë").
[193] Nenet 58(3) dhe 62, KPrP i Moldavisë.
[194] Neni 58(3), (6), KPrP i Moldavisë.
[195] Neni 61, KPrP i Moldavisë.
[196] Neni 62 (1) (20), KPrP i Moldavisë.
[197] Neni 59 (1)-(2), KPrP i Moldavisë.
[198] Nenet 60 and 62, KPrP i Moldavisë.
[199] Neni 81, KPrP i Moldavisë.

dëshmitarëve, duhet t'u ofrohet mundësia e rimbursimit të shpenzimeve të kryera gjatë pjesëmarrjes në procesin penal.[200] Kjo përfshin pagesën e shpenzimeve për dëshmitarët që jetojnë në një shtet tjetër, për udhëtimin e tyre, si dhe të shpenzimeve për vendosjen e komunikimeve teknologjike, si për shembull lidhjet me telefon apo video.

Kodi i procedurës penale kërkon që të gjitha vendimet gjyqësore të dënimit duhet të përfshijnë, ndër të tjera, disponimin e padisë civile në qoftë se padia e tillë është ngritur. Gjithashtu, kodi i jep gjykatës kompetencë për të marrë vendimin lidhur me zhdëmtimin e dëmeve materiale si dhe vendimin lidhur me konfiskim të veçantë pavarësisht nga fakti nëse viktima ka paraqitur ose jo një kërkesë padi për këtë.[201] Gjykata është kompetente edhe për të ndarë padinë civile dhe t'ia dërgojë atë gjykatës civile për zgjidhje.

Mundësitë e shumta për të patur status në gjykatën penale mund të duken çorientuese dhe në praktikë mund të kërkohet që viktima detyrohet të dëshmojë disa herë. Megjithatë, këto statuse u japin viktimave legjitimimin dhe mundësojnë praninë e tyre në procesin gjyqësor.

Në përgjithësi, Kodi i Procedurës Penale kërkon që të gjitha vendimet e gjykatave të jenë përfundimtare, para se ato të ekzekutohen.202 Për çdo vendim, gjykata i lëshon paditësit një urdhër ekzekutimi.203 Urdhri i dorëzohet zyrës së ekzekutimit që operon pranë asaj gjykate.204 Kërkesa për ekzekutim të detyruar duhet të depozitohet pranë gjykatës që ka shqyrtuar çështjen dhe ka marre vendim. Vendimet civile të marra në proceset penale ekzekutohen sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale.205 Kodi parashikon gjithashtu procedura për ekzekutimin e detyrueshëm në rastet kur asetet ose mjetet financiare janë të pamjaftueshme për kompensim.206

Nën rrethana specifike, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës që të urdhërojë ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit gjatë procesit gjyqësor ose me shpalljen e vendimit. Kjo mund të kërkohet kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar, se ekzekutimi i mëvonshëm do të

[200] Neni 7, Vendimi Kuadër i Këshillit Evropian për legjitimimin e viktimave në procesin penal.
[201] Neni 385(11) dhe neni 397(1), (2), (4), (5), KPrP i Moldavisë.
[202] Neni 467(1), KPrP i Moldavisë.
[203] Neni 468, KPrP i Moldavisë.
[204] Zyrat e ekzekutimit janë pjesë e Drejtorisë së Ekzekutimit të Ministrisë së Drejtësisë.
[205] Neni 469(2), KPrP i Moldavisë.
[206] Neni 255, KPrP i Moldavisë.

sfiduar atë.' E para me sa duket i referohet një sulmi fizik, ndërsa e fundit i referohet fjalosjeve.

Paditë për dëmshpërblim duhet të regjistrohen në gjykatën e shkallës së dytë ku ka vendbanimin viktima. Pranë secilës nga këto gjykata, është ngritur një Shërbim për Lirimin me Kusht dhe Mbrojtjen e Viktimave. Paditë për dëmshpërblim trajtohen nga Bordi për Dëmshpërblime Financiare për Viktimat e Krimit, i cili përbëhet të paktën nga dy gjyqtarë. Në procedurë nuk ka nevoje për dhënien e provave gojore, por në përgjithësi viktima duhet të jetë e pranishme në seancë.

Kur kërkesa bëhet me shpejtësi, pagesa "paraprake" mund të jepet që në fillim të procedurave.

Pagesat e dëmshpërblimit nga skema shtetërore e dëmshpërblimit mbulojnë shpenzimet e shtrimit në spital, shpenzimet mjekësore, shpenzimet e varrimit, dëmet materiale (p.sh., dëmet për sende të veçanta të cilat kanë një vlerë tregu), humbjet e të ardhurave dhe mirëmbajtjen për personat në ngarkim.

Skema nuk përfshin "dëme morale," megjithëse këto dëme mund të pretendohen dhe mund të ngrihen me anë të padisë civile (shih më poshtë). Pagesat e bëra me anë të padisë civile për dëmet nga autori i veprës ose nga pagesat e siguracioneve mund të zbriten nga pagesa e dëmshpërblimit (ose anasjellas).

Ndërsa në teori, skema u afrohet standardeve evropiane, për sa i përket zbatimit praktik, nuk funksionon ende mire. Megjithëse skema nuk është shumë burokratike, organet shtetërore nuk kanë ende fondet e nevojshme. Për më tepër, ekziston një problem i vazhdueshëm i armiqësisë ose antagonizmit nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve për personat e trafikuar, të cilët i konsiderojnë viktimat "se janë po aq fajtore sa dhe kriminelët."[227] Ka gjithashtu probleme në informimin e viktimave për të drejtat e tyre (shih më poshtë seksionin "ndihmë për viktimat").

Legjislacioni nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët. Kjo vjen si rezultat i faktit se dëmet janë të kufizuara në llojet specifike të dëmeve materiale. Nëse jepet dëmshpërblimi, paratë e marra duhet të administrohen nga kujdestarët ligjorë të fëmijës dhe zakonisht nuk ka mbrojtje ose kontroll nga autoritetet e mbrojtjes së fëmijëve. Kjo do të thotë se paratë mund të përdoren shumë kollaj në mënyra që nuk janë në dobi të viktimave që janë fëmijë.

[227] Përgjigje e pyetësorit nga një jurist i shoqatës ADPARE.

e vendimit për dëmshpërblim. Për më tepër, çështja mund të zgjasë shumë; ndonjëherë ajo zgjat jo vetëm disa muaj, por me vite.

Gjykata civile mund të njohë të njëjtat kategori dëmesh si skema e dëmshpërblimit me shtesën e dëmeve 'morale.' Këtu përfshihen dëmshpërblimi i pastër për dëmin fizik dhe psikologjik, vuajtja morale, shkaktimi i stresit, cenimi i emrit të mirë dhe i figurës publike. Koncepti i dëmit moral në të drejtën rumune u rifut pas rënies së Komunizmit, dhe përllogaritja dhe pagesa e tij në Rumani ende është subjekt i debateve të shumta në profesionin ligjor dhe juridik. Kjo mund të çojë në një farë arbitrariteti dhe mungese të koherencës në masën e dhënë në vendimet. Dëmet vendosen nga gjykatat sipas konstatimeve të saj në lidhje me pretendimet e viktimës, seriozitetin e çështjes dhe dëmin moral. Pavarësisht nga lloji i procedimit, provat duhet paraqitur (d.m.th., në qoftë se pretendohen dëme për dëmtime fizike ose psikologjike, duhet të identifikohen me anë të raporteve mjekësore). Të gjitha dëmet e tjera kërkojnë fatura dhe dokumentacione, ose me dëshmitarë, për kontrata ose të ardhura nën 250 RON.[230]

Sipas një prokurori rumun, ka pasur vetëm katër çështje trafikimi ku është marrë vendim për dëmshpërblim. Ky numër i kufizuar i çështjeve të suksesshme ka ndikim mbi besimin e njerëzve të tjerë të trafikuar se sistemi i drejtësisë mund të shpërblejë dëmin.[231] Një çështje që shërben si shembull është dhënë nga OJF-ja ADPARE për tri gra të trafikuara për shfrytëzim seksual në Turqi, njëra prej të cilave mbeti shtatzënë nga shfrytëzimi, dhe kërkoi dëmshpërblimin e dëmit material dhe moral në procesin civil. Dy prej viktimave iu dhanë 5000 RON (1480 EUR) dhe tjetra, 4000 RON (1184 EUR). Trafikantët u dënuan njëri me 12 vjet 8 muaj dhe tjetri me 8 vjet heqje lirie. Këto vendime u lanë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj në vitin 2006. Gjithsesi, ka probleme të vazhdueshme për zbatimin e vendimeve.

Kur merret një vendim gjykate për dëmet civile, viktima më pas has problemin e marrjes së pagesës nga trafikanti/kujdestari/punëdhënësi. Nëse kjo nuk realizohet me vullnet të lirë, atëherë viktima është e detyruar të aplikojë pranë një "përmbaruesi gjyqësor" për ekzekutimin civil, procedurë e cila është e ndërlikuar dhe me shpenzime të larta. Është e qartë se ka shumë mundësi që dëmet nuk do të paguhen kurrë.

[230] Deri në rivlerësimin e monedhës rumune 'leu' (sipas ISO-së 4217, ROL) në vitin 2006, barra e palës paditëse për provat e dokumentuara për të gjitha kontratat dhe të ardhurat mbi 250 ROL ishte shumë e lartë (250 ROL kishte vlerë shumë të ulët). Kjo çoi në mosparaqitjen e kërkesave. Gjithsesi, 250 RON (lei të rinj) barazohet me 2.5 milionë ROL, kështu që problemi u zgjidh.
[231] Informacion i dhënë nga prokurorja Iulia Diaconu, në seminarin e ODIHR-it në Barcelonë, dhjetor 2008, shih shënim 43.

pamundur që ato të përfitojnë nga masat mbrojtëse, duke përfshirë dëmshpërblimin.[234] Për shembull, gjatë gjyqeve, gjyqtarët në mënyrë jo të saktë u drejtohen viktimave si "dëshmitarë" dhe jo si "palë të dëmtuara," dhe kjo tendencë i mohon viktimës disa të drejta të caktuara ligjore.[235]

Këshillimi psikologjik pa pagesë për deri në tre muaj (deri në gjashtë muaj për fëmijët) duhet t'u vihet në dispozicion viktimave të veprave penale të përmendura në Ligjin kundër Trafikimit dhe të konfirmuar në Ligjin për Mbrojtjen e Viktimës 211/2004. Ky këshillim duhet të ofrohet nga Shërbimi (shtetëror) për Lirimin me Kusht dhe Mbrojtjen e Viktimave.

Pavarësisht nga fakti që ligji përmban një angazhim mbi ndihmën ligjore për personat e trafikuar (neni 44), ai është i paqartë në lidhje me faktin se kush ka të drejtë, çfarë lloj ndihme duhet të jepet dhe nëse kjo ndihmë shtrihet edhe për proceset civile dhe në paditë për dëmshpërblim. Si rezultat, ai ka qenë subjekt kritikash.[236] Në praktikë, duket sikur ndihma ligjore, në përgjithësi, jepet, pas aplikimit, për viktimat e drejtpërdrejta të krimeve të rënda, duke përfshirë të gjitha viktimat e trafikimit,[237] viktimat jo të drejtpërdrejta, ku viktima e sëmurë ka vdekur, kur viktima është nën moshën 18 vjeç dhe kur viktima edhe pse e rritur nuk ka mjete financiare. Gjithsesi, edhe kur jepet ndihma ligjore, pagesa që marrin avokatët për këtë punë nuk është e lartë, dhe si rezultat, standardi i ndihmës mund të jetë i ulët. Për shkak të këtyre faktorëve, OJF të specializuara e kanë marrë përsipër këtë rol, duke përdorur fondet e tyre.

Agjencia Kombëtare për Parandalimin e Trafikimit të Personave dhe për Monitorimin e Ndihmës për Viktimat e Trafikimi të Qenieve Njerëzore, e cila është krijuar kohët e fundit, duhet të jetë në gjendje të monitorojë dhe të përmirësojë ndihmën për viktimat e trafikimit, por ekzistenca dhe ndikimi i saj janë shumë të reja për t'u vlerësuar në këtë raport. Në vitin 2006, Agjencia iu nënshtrua një proces riorganizimi, por Ministria e Drejtësisë tha se ajo do të përbëhej nga 15 qendra rajonale dhe një linjë telefonike këshillimi. Janë krijuar qendra tranziti për qendra të përkohshme dhe ndihmën me traumat. Megjithatë, edhe duke marrë si të mirëqena shifrat e vetë qeverisë, këto masa duket sikur i kanë ardhur në ndihmë vetëm një pjesë të vogël të viktimave të identifikuara (në vitin 2006 merrnin ndihmë 132 nga më shumë se 1000 viktima).[238]

[234] V. cit., shënimi 226, raporti i UNICEF-it, f. 42.
[235] Po aty.
[236] Shih v. cit., shënim 226, raporti i UNICEF-it, f. 63 dhe rekomandimin nr 3, f. 95. Shih gjithashtu gjyqtare Nicoleta Stefaroi, shënim 233.
[237] Neni 44 i Ligjit të Trafikimit.
[238] Shih shënim 221, raportin e Ministrisë së Drejtësisë, f. 8-9.

5.4.3 Përfundime për Rumaninë

Rumania ka bërë hapa të dukshëm përpara drejt përmirësimit të situatës së viktimave të krimit në përgjithësi dhe viktimave të trafikimit në veçanti. Këta hapa janë reflektuar në faktin se vendi ka ratifikuar KEDVKDh-në dhe Konventën Evropiane kundër Trafikimit.

Në mënyrë që skema e krijuar kohët e fundit për viktimat e trafikimit të ketë më shumë përfitime të prekshme, duhet të rishikohen dispozitat mbi dëmet për të përfshirë elementin e dëmit moral. Sipas kufizimeve aktuale për llojet e dëmeve të disponueshme dhe detyrimit për t'u bërë paditës civil në procesin penal, viktimat e trafikimit duhet të ndjekin dy rrugë për dëmshpërblim. Ky proces mund të çojë në ndrojtje nga viktimat dhe gjithashtu do të kërkojë shumë kohë. Do të ishte mirë që shteti të krijonte sistemin sipas të cilit shteti do të paguante dëmshpërblimin, por do të kishte edhe të drejtën për të ngritur padi civile ndaj autorit të veprës dhe, si rrjedhojë, të marrë rimbursimin e një pjese të pagesave për viktimën (krahaso sistemet e Ukrainës, të propozuar, dhe të Francës). Kur viktima nuk është në gjendje ta identifikojë autorin, ajo do të kishte të drejtë vetëm për dëme materiale. Kriteret e tjera për përfitimin nga skema, në veçanti kërkesa që dhuna të ketë përdorur, si dhe afatet kohore, mund të kenë gjithashtu ndikim negativ tek personi i trafikuar dhe duhet të rishikohen pas një periudhe vlerësimi. Rishikimi mund të përfshijë edhe vëzhgimin dhe vlerësimin e shpejtësisë me të cilën procedohet me paditë dhe të ndihmës që u jepet personave të trafikuar.

Viktima mund të ngrejë padi civile brenda procesit penal për të gjitha llojet e dëmeve dhe për këtë mund të marrë ndihmë ligjore falas. Detyrimet e aktorëve shtetërorë për të informuar viktimat për këtë të drejtë kohët e fundit janë forcuar. Gjithsesi, duket sikur në praktikë përfaqësimi dhe informimi vjen ende kryesisht nga komunitetit i OJF-ve, i cili ia ka arritur që të argumentojë me sukses për dëme morale.

Është pozitive që gjykatat janë të gatshme të japin dëmshpërblime morale në shuma të arsyeshme, edhe pse nuk është e qartë mbi ç'bazë bëhen përllogaritjet.

Si në të gjitha juridiksionet, vëmendje i duhet kushtuar përmirësimit të sekuestrimit të pasurisë, si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pasi, megjithëse janë parashikuar kompetenca, ato nuk sigurojnë se viktimat marrin dëmshpërblim në masën e vendosur në vendimet e gjykatave.

Evropës Lindore, të cilat në përgjithësi nuk japin udhëzime në lidhje me kuptimin e dëmeve morale. Kuptimi i dëmeve morale i lihet në dorë gjyqtarit. Kjo konsiderohet si problematike, pasi dëmet vlerësohen mbi bazën e "arsyes" dhe të "drejtësisë," të cilat nga ana e gjyqtarëve kanë rezultuar të jenë koncepte të vështira për interpretim. Rrjedhimisht, dëmshpërblimet e dhëna kanë qenë minimale.[256]

Që prej vitit 1992, Kodi përcakton se padia civile në procesin penal më pas ndahet në procesin e veçantë. Në praktikë, gjyqtarët i shqyrtojnë këto padi pasi është dhënë dënimi në çështjen penale, kështu që në qoftë se vendimi nuk është i plotë, ai mund ta ndalojë shqyrtimin e padisë civile në të njëjtën kohë.[257]

Në fillim të hetimeve është procedura formale, sipas së cilës viktima nënshkruan protokollin ku thuhet se ajo konsiderohet si "palë e dëmtuar" dhe se do të marrë pjesë në këtë cilësi në procesin penal. Viktima, si palë e dëmtuar në proces, duhet të njoftohet nga oficeri i policisë/hetuesi ose prokurori për të drejtat e saj, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur padinë civile gjatë procedurave penale. Gjykata nuk mund ta kërkojë këtë kryesisht, prandaj është shumë e rëndësishme që viktimat ta kërkojnë të drejtën e tyre në këtë fazë. Prokurori mund të ngrejë padinë civile vetëm në emër të fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuar ose të individëve të tjerë të cilët për arsye të ndryshme, nuk mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre.[258] Kështu që pala e dëmtuar detyrohet të ngrejë padinë civile dhe të sjellë prova për ta mbështetur atë. Duke qenë se padia civile rregullohet me anë të ligjeve të ndryshme, pala e dëmtuar nuk është në gjendje ta mbështesë atë pa kështillim ligjor dhe në përgjithësi ky kështillim nuk ofrohet pa pagesë.[259] Policia dhe prokurorët detyrohen të mbledhin prova të mjaftueshme për të treguar se i dyshuari ka kryer krimin, por ata nuk detyrohen që mbledhin të dhëna për të provuar natyrën dhe shkallën e dëmeve që ka pësuar viktima. Kjo është përgjegjësia e palës paditëse. Nëse gjykata konstaton që nuk provohen dëmet, atëherë ajo mund ta rrëzojë padinë civile.

Viktimat e trafikimit kanë mundësi të hedhin në gjyq trafikantin, pavarësisht nga fakti nëse çështja po hetohet ose po zhvillohet një gjykim civil ndaj atij personit. Ashtu siç është e zakonshme në të gjitha çështjet civile, viktima duhet të provojë fakte për veprimet që ajo mendon se kanë çuar në dëme dhe të japë prova për vlerën e dëmeve. Këto janë procese të gjata dhe të lodhshme, dhe disa ekspertë kanë mendim se trafikantët ose punëdhënësit/shfrytëzuesit ndonjëherë kërkojnë mbrojtje nga zyrtarët e lartë pranë

[256] V. cit., shënimi 252, Trunov.
[257] Shih vlerësimin e ODIHR-it i MRK-së në Federatën Ruse.
[258] Neni 44, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale.
[259] http://www.pvlast.ru/archive/index.pr378.php .

Neni 381 i Kodit të Punës parashikon rrethanat në të cilat mund të trajtohet mosmarrëveshja individuale e punës. Ai specifikon, se punonjësi individual dhe punëdhënësi "të cilët më parë kanë qenë në marrëdhënie pune" kanë të drejtë të ngrenë padinë. Në praktikë, shumë persona të trafikuar janë punonjës të padokumentuar, kështu që marrëdhëniet e tyre të punës janë jozyrtare dhe të paregjistruara, që do të thotë që ata nuk do të mbrohen nga Kodi i Punës. Neni 11 rregullon marrëdhëniet e punës për nënshtetasit e huaj me status të rregullt (ata që kanë lejen e duhur të lëshuar në përputhje me nenin 18). Një problem tjetër është kur punonjësit emigrantë, të cilët dëshirojnë ta ngrenë padinë në gjykatë, mund të kenë liri të kufizuar lëvizjeje, gjë që sjell pamundësinë për t'iu drejtuar avokatit, OJF-ve ose gjykatës,[263] ose ata mund të jenë të frikësuar se mos dëbohen për shkak të statusit të tyre të parregullt. Pra, për punonjësit që janë emigrantë të parregullt, legjislacioni rus nuk ofron mbrojtje nëpërmjet së drejtës së punës.[264]

Gjithsesi, për sa u përket viktimave të shfrytëzimit të punës, kërkesat për dëmshpërblim janë negociuar me sukses nga sindikatat ose përfaqësuesit e OJF-ve, në emër të punonjësve emigrantë të trafikuar ose të shfrytëzuar. Sipas Sindikatës së Punonjësve të Ndërtimit, punonjësit në përgjithësi janë të frikësuar nga dalja e mundshme në gjykatë dhe parapëlqejnë t'i drejtojnë pretendimet e tyre për pagat e papaguara ose të nënpaguara ose për dëmtimet e lidhura me punë, nëpërmjet bisedimeve në telefon.[265] Kështu që, këto pretendime nuk trajtohen në mënyrë strikte brenda kuadrit ligjor. Për më tepër, sindikatat kanë akses vetëm në vendet e punës ku punon të paktën një anëtar, dhe prandaj kërkohet që punonjësit të anëtarësohen në sindikatë për të marrë përfaqësim dhe ndihmë prej tyre.[266]

Sipas një OJF-je që ndihmon kryesisht punonjës emigrantë nga Taxhikistani, "Qendra e Ligjeve dhe e Migracionit/Fondacion Taxhikistan," gjykatat janë më pak efikase në sigurimin e dëmshpërblimit sesa negociatat. OJF-ja merr të dhëna për forcë pune dhe punëdhënësin nga personi që kërkon ndihmë dhe fillon negociatat telefonike, të pasuara nga paralajmërime për proces ligjor, dhe kërkon ndihmë nga sindikata përkatëse. Ata përdorin gjithashtu dhe Shërbimin Federal të Emigracionit, i cili mund t'i gjobisë punëmarrësit për marrjen në punë të emigrantëve të paligjshëm. Këto metoda kanë pasur sukses.[267]

[263] V. cit., shënimi 245, Tyuryukanova, f. 24-25.
[264] Po aty, f. 27.
[265] V. cit., shënimi 250, vlerësimi i MRK-së në Federatën Ruse, f. 3.
[266] Informacion i marrë nga ODIHR-i gjatë intervistave pranë Sindikatës së Punonjësve të Ndërtimit, Moskë, korrik 2006.
[267] Informacion i marrë nga Elena Tyuryukanova gjatë kërkimit të saj për vlerësimin e ODIHR-it të MKR-së. Shih gjithashtu vlerësimin e ODIHR-it të MKR-së në Federatën Ruse.

Gjithsesi, mjaft nga punonjësit emigrantë më të cenueshëm që janë të trafikuar ose të shfrytëzuar punojnë në mjedise tërësisht pa sindikata, nuk kanë kontratë ose leje pune dhe shpesh jetojnë në situata të tilla, ku liria e lëvizjes dhe e mundësitë e komunikimit janë të kufizuara. Si rezultat, ata nuk mund të përfitojnë nga ndihma e sindikatave dhe pretendimet e tyre për dëmshpërblim të mbështetur në ekzistencën e marrëdhënieve të punës bëhen shumë të vështira për t'u paraqitur dhe për t'u provuar në gjykatë. E gjitha kjo duhet parë nën këndvështrimin e faktit, që edhe punonjësit e rregullt e kanë të vështirë zbatimin e të drejtave të tyre të punës.[268]

5.5.2.3 Sekuestrimi i pasurisë

Punonjësi i policisë ose prokurori mund të kërkojë nga gjykata kufizime mbi pasuritë që në fillim të një procesi hetimi, me qëllim që të parandalohet tjetërsimi i shpejtë të pasurive të personit i cili e kupton se është nën hetim.[269] Konfiskimi i pasurive ose përdorimi i tyre si dëmshpërblim është më pas i mundshëm në proceset penale për vepra të caktuara (duke përfshirë dhe trafikimin).[270] Kjo përfshin vetëm:

> "Nenin 104.1 a. dhe b.: Paratë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera të përfituara nëpërmjet sjelljes kriminale ose përfitimeve të saj (ose barasvlerë në "formën e tyre të konvertuar," p.sh., përfitimet e krimeve që përdoren për të blerë një shtëpi).
>
> "Nenin 104.1 c.: Paratë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera që përdoren për të financuar terrorizmin, njësinë e armatosur ose organizatën kriminale,
>
> "Nenin 104.1 d.: Armët, pajisjet ose instrumente të tjera të krimit që i përkasin të akuzuarit."

[268] Shih raportin e ILO-s, 2007, për Konventën e Mbrojtjes së Pagave në Federatën Ruse, 1949 (nr. 95) (ratifikimi: 1961): "... Komisioni kujton vëzhgimet e tij të mëparshme në lidhje me fenomenin e vazhdueshëm të akumulimit të pagave të papaguara të akumuluara që prekin miliona punëtorë dhe familjet e tyre dhe nevojën për të intensifikuar përpjekjet e Qeverisë në mënyrë që të parandalohet që fenomeni të transformohet në një proces endemik ose ciklik. Vihet re me keqardhje se raporti i Qeverisë nuk është marrë ende. Për më tepër, Komisioni konstaton vëzhgimet e bëra nga Unioni i Pavarur i Peshkatarëve të Kamchatkasë në lidhje me zbatimin e Konventës. Organizata e punëtorëve pretendon se pagat, të cilat duhen peshkatarëve dhe punëtorëve në lëmin e prodhimit të produkteve të peshkut – një degë e aktivitetit ekonomik më forcë pune të vlerësuar në 20,000 peshkatarë që gjeneron 80,000 vende pune te bregdeti – në përgjithësi nuk paguhen, dhe se nuk ka mjete të duhura dhe efektive për të siguruar pagat e papaguara. Komiteti e fton Qeverinë që të përgjigjet në mënyrë që këto komente të mund të shqyrtohen në detaje në sesionin pasardhës. Qeverisë i kërkohej të japë përgjigje në detaje për komentet aktuale brenda vitit 2007.

[269] Neni 115 i Kodit të Procedurës Penale të Federatës Ruse.

[270] Neni 15.1, 104.1-3 i Kodit Penal të Federatës Ruse 20.11.2006, neni 115 i Kodit të Procedurës Penale 20.11.2006.

territorin e Ukrainës është kryer një krim i qëllimshëm dhune, i cili shkakton vdekje ose cenim të shëndetit.[285] Parashikohet që shteti do t'i paguajë dëmshpërblim viktimës, pavarësisht nga fakti nëse autori i krimit është identifikuar dhe po ndiqet penalisht ose është në kërkim. Kurdo të jetë e mundur, shteti mund të ngrejë padinë civile ndaj autorit të krimit për dëmshpërblimin që i është "parapaguar" viktimës.[286]

Parashikohet që skema të drejtohet nga komisione të krijuara nga Ministria e Punës dhe të Politikës Shoqërore.[287] E drejta për dëmshpërblim kufizohet për: nënshtetasit e Ukrainës, personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Ukrainë, rezidentë të përhershëm në Ukrainë që janë nënshtetas të një shteti anëtar të Këshillit të Evropës, shtet i cili ka një skemë dëmshpërblimi, ose nënshtetas të një shteti palë të KEDVKDh-së.[288]

Për realizimin e së drejtës për dëmshpërblim, viktima ose kërkuesi duhet ta ketë denoncuar krimin brenda 48 orëve nga pasja e "mundësisë reale" për ta bërë këtë gjë, dhe në rastin e hetimit penal duhet t'i kryejë me përkushtim detyrimet procedurale.[289] (Midis provave e tjera shkresore kërkohet[290] edhe kopja e vendimit që jep statusin e viktimës). Arsyet për refuzimin e dëmshpërblimit përfshijnë: rrethanat, kur personi me vetëdije e pranoi rrezikun e dëmtimit ose të vdekjes; rastet e plagosjes ose vdekjes së shkaktuar vetë; ose kur viktima i pëson dëmet si rrjedhojë e marrjes pjesë në një konflikt politik ose ushtarak.[291] Dëmet do të përfshinin humbje të të ardhurave, shpenzime mjekësore, spitalore dhe shëndetësore, shpenzime për varrimin dhe mjetet e jetesës për personat në ngarkim. Megjithëse dëmet morale nuk mbulohen, ligji e lejon shprehimisht viktimën që ta padisë të pandehurin, duke ngritur pretendime të tjera, përveç atyre të paraqitura në padinë ekzistuese.[292]

Edhe kur nuk ka asnjë të pandehur të identifikueshëm, ky ligj paraqet mundësinë e dëmshpërblimit të personave të trafikuar, gjë që nuk ndodhte më parë. Ekziston gjithashtu edhe garancia e pagesës nga shteti. Në raste të tjera, ligji e sheh shtetin thjesht si ndërmjetës në procedimet civile, duke e lehtësuar viktimën nga barra për ta ndjekur padinë civile brenda procesit penal, apo në mënyrë të pavarur prej tij, gjithashtu duke siguruar pagesën për viktimën. Viktimat mund të kërkojnë edhe dëme të tjera që nuk mbulohen nga dëmshpërblimi shtetëror nëse ata e ndjekin vetë kërkesën, nëpërmjet prokurorit apo avokatit

[285] Neni 2 i projektligjit për dëmshpërblimin e viktimave të krimeve të dhunshme.
[286] Po aty, neni 22.
[287] Po aty, neni 12.
[288] Po aty, neni 4.
[289] Po aty, neni 5.
[290] Po aty, neni 8.
[291] Po aty, neni 11.
[292] Po aty, neni 6.

afërmi (ose të një punonjësi social apo një përfaqësuesi nga një OJF).[313] Viktima propozon përfaqësuesin, ndërkohë që personi që drejton hetimet apo gjyqtari e pranon ose e rrëzon propozimin. Viktimat dhe përfaqësuesit mund të marrin pjesë në gjykatë si palë dhe përpara gjykatës gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta në paraqitjen e provave, shqyrtimin e tyre dhe argumentimin e rëndësisë së tyre.[314] Si "palë civile paditëse," viktima gëzon të drejta të tjera.[315]

Gjithsesi, nuk ka ndihmë ligjore falas, as lehtësi të subvencionuara nga shteti për të ndihmuar viktimat me avokatë, gjë që ndikon në mënyrë negative në zbatimin e të drejtave të tyre:

> "Pa avokat, shanset e viktimës që të jetë në gjendje të mbrojë çështjen e saj janë minimale. Në teori, prokurori ka detyrim që të mbrojë interesat e viktimës; në praktikë, për ta realizuar këtë gjë viktima është shumë e varur nga avokati."[316]

Në çështjet e shqyrtuara nga studimi Shvab, [317] më pak se gjysma e viktimave përfaqësoheshin nga avokatë. Të tjerat ose e kishin të pamundur të gjenin avokatin, apo nuk mund të paguanin tarifat, ose nuk donin të kishin avokatin e rekomanduar. Në disa raste, i njëjti avokat përfaqësonte viktima të ndryshme. Shpesh avokatët nuk i takonin klientët para seancës gjyqësore, dhe nuk i përgatisnin viktimat për në gjyq. Në lidhje me cilësinë e përfaqësimit, ka një gamë të gjerë gjetjesh, por disa prej përfaqësuesve të viktimave konsideroheshin si pa përvoje dhe të paaftë në punën e tyre.

- të paraqesin kërkesa, - të shqyrtojnë të gjitha materialet e çështjes që nga momenti i përfundimit të hetimeve paraprake, ose nga momenti i transferimit të çështjes për shqyrtim në gjykatë (për çështje ku nuk përfshihen hetime paraprake); - të marrë pjesë në shqyrtimet gjyqësore; - të paraqesë mocione në lidhje me pushimin e çështjes; - të ankimojë veprimet e personit përgjegjës për hetimin, e hetuesit, të prokurorit dhe të gjykatës, si dhe të ankimojë vendimin e gjykatës ose urdhrat e gjykatës dhe rezolutat e gjyqtarit popullor; dhe të japë arsyet përkatëse – si dhe e drejta për ta patur të garantuar sigurimin e tij/saj. Në rastet e parashikuara në KPrP, viktima ka të drejtë të mbështesë akuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij/saj. Viktima mund të marrë pjesë në debatet në gjykatë."

[313] Neni 52.

[314] Neni 16(1) i KPrP.

[315] Siç citohet në v. cit., shënimi 312, M. Wijers dhe R. Haveman, neni 50 i KPrP, Të drejtat e paditësit civil: "një paditës civil ose përfaqësuesi i tij kanë këto të drejta: - të paraqesin prova; - të paraqesin kërkesa; - të marrin pjesë në shqyrtimet gjyqësore; - t'i drejtojë organizmit hetimor, hetuesit ose gjykatës kërkesa për marrjen e masave në mënyrë që të sigurohet zbatimi i padive; - për të ndjekur padinë civile; - për të shqyrtuar materialet e çështjes që nga momenti i përfundimit të hetimeve paraprake, ose nga momenti i transferimit të çështjes për shqyrtim në gjykatë (për çështje në të cilat nuk përfshihen hetime paraprake) – të paraqësë mocione në lidhje me pushimin e çështjes; - të ankimojë veprimet e personit përgjegjës për hetimin, e hetuesit, e prokurorit dhe e gjykatës; si dhe të ankimojë vendimin ose urdhrat e gjykatës deri në masën e lidhjes së tyre me padinë civile; dhe të japë arsyet përkatëse; - si dhe të drejtën për të garantuar sigurimin e tij."

[316] Raporti i IOM-it; shih më lart shënim 312.

[317] Po aty. V. cit., shënim 297, Shvab, f. 109-110, versioni i botuar në Ukrainë.

5.6.3 Përfundime mbi Ukrainën

Janë bërë përpjekje të mëdha për të ndërtuar strukturën juridike që zbaton të drejtat ligjore të viktimave në Ukrainë, duke përfshirë këshillat për llojet dhe shtrirjen e dëmeve që mund të kërkohen. Ekziston edhe një propozim për skemën e dëmshpërblimit të financuar nga shteti, e cila, ndonëse do të ishte e disponueshme vetëm për viktimat e krimeve të rënda dhe do të mbulonte vetëm dëmet materiale, meriton konsideratë dhe mund të ketë ndikim të ndjeshëm në arritjen e pagesave të vendimeve për dëmshpërblim. Gjithsesi, shtetit i duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të siguruar se komisionerët të jenë emëruar dhe të trajnohen, se ata do të kenë në dispozicion sistemin administrativ që realisht mund të përdoret, dhe se janë udhëzuar në masën e mjaftueshme për të marrë vendime konsekuente.

Nga ana tjetër, e drejta për të ngritur padi civile kundër një të akuzuari brenda procesit penal njihet mirë, ashtu si dhe e drejta për t'u informuar për të drejtat dhe për t'u përfaqësuar në proces. Ekziston gjithashtu jurisprudence e bollshme, kur dëmshpërblimi është dhënë në çështjet që janë identifikuar si çështje trafikimi për shfrytëzim seksual. Kjo vjen nga një komunitet aktiv OJF-sh dhe avokatësh që japin ndihmë dhe këshilla për personat e trafikuar, dhe e gjithë kjo ka ndihmuar në zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Në parim, gjykatat e pranojnë se viktimat kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim, dhe se kompensimi për dëme mund të jepet. Është demonstruar se dëmet morale janë më me rëndësi se sa ato materiale, pasi personat e trafikuar në përgjithësi nuk kanë qenë në gjendje që të mbështesin me dokumentacion përkatës pretendimet për dëmet materiale. Fatkeqësisht, si në shumë juridiksione, viktimat rrallë, për të mos thënë kurrë, marrin pagesa sipas vendimeve që jepen.

Gjithsesi, praktika në gjykatat penale duket se nuk është konsekuente, kur bëhet fjalë për hartimin e padive civile, për trajtimin e tyre, për vendimmarrjen në lidhje me vlefshmërinë e tyre dhe në nivelin e shumave që jepen në vendimet. Është evidentuar se në disa raste, gjyqtarët udhëhiqen nga supozimet e tyre personale rreth trafikimit, dhe jo nga provat, kur vendosin për paditë civile. Janë evidentuar gjithashtu raste të 'shlyerjes' së viktimave nga trafikantët, për t'i bindur ato të tërhiqen nga procesi ligjor. Kjo tregon nevojën për këshillim dhe trajnim të gjyqtarëve, policëve dhe prokurorëve, në lidhje me sensibilizimin për çështjet e trafikimit dhe në lidhje me llogaritjen në mënyrë konsekuente të dëmeve që duhet shpërblyer.